

Prill 2023
Numri: 181
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.progresibotime.com

ETIKA



**THJESHTËSIA
E ZEMRËS ËSHTË PASURI**



revistaetika



progresibotime

Fjala më e bukur është Libri i Allahut. Rruga më e mirë është sunneti profetik. Streha më e sigurt është devotshmëria. Të folurit më me virtyt është përmendja e Allahut.

Tregimet më të bukura gjenden në Kuran. Rrugët më të ndritura janë rrugët udhëzuese të profetëve.

Dija më e mirë dhe më e dobishme, është ajo që kthehet në kulturë. Justifikimi më i keq është ai që bëhet në momentin e vdekjes. Pendimi më i keq, është ai në ditën e kiametit. Pasuria më e mirë, është ajo e zemrës.



Besimtarët janë në trupa të ndryshëm, ata janë të detyruar ta konsiderojnë njëri-tjetrin si organet e një trupi që jetojnë me një zemër të vetme. Ashtu siç i gjithë trupi e ndjen dhimbjen e një organi, edhe perceptimi i vuajtjeve të vëllezërve të fesë, është një sprovë ndërgegjeje për të gjithë besimtarët.

Allahu i Lartëmadhëruar i ka krijuar njerëzit nevojtarë ndaj njeri-tjetrit. Shoqëria, ashtu si ka klasën e pasur dhe të fortë, ka e do të ketë gjithmonë edhe klasën e të dobëve, të njerëzve me probleme shëndetësore dhe të nevojtarëve. Ne duhet të pyesim veten: "Pse i krijoi Allahu i Lartëmadhëruar nevojtarët?" Përgjigjja dihet: "Nevojtarët janë amanet i Allahut (xh.sh.), që ua ka lënë jonevojtarëve." Këtë përgjegjësi e ka dhënë Vetë Allahu.



Prill 2023

VITI: XVII

NUMRI: 181

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

PËRKTHYES

Albert Halili
Fatmir Sulaj
Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"
Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

ËEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin
Prizren; Kosovë
Mob: +377 45 639 143
Prishtinë; Kosovë
Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija
Skopje; Makedonija
Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë
Kosovë: 15 Euro
Maqedoni: 900 Denar
Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Jeta e thjeshtë e vënë në dukje nga tevhidi dhe suneti është një jetë me një qëllim të caktuar që në fillim. Ai që e fokuson zemrën, mendjen dhe jetën në një pikë të vetme, do të fitojë. Ajo pikë është kënaqësia e Allahut (xh.xh.). Ne i përcaktojmë të gjitha marrëdhëniet tona, punët tona, ardhjet tona, ikjet dhe mendimet tona, madje edhe kur e ngremë gotën dhe e vendosim diku tjetër, vetëm për hir të Allahut. Të bësh shumë punë, të hysh e të dalësh nga shumë vende nuk është ndonjë gjë e madhe. Çështja është aftësia për ta lidhur gjithçka me Allahun (xh.xh.). Një jetë e thjeshtë ka si përparësi fitimin e kënaqësisë së Zotit, i Cili na ka krijuar. Ata që ndjekin këtë rrugë minimizojnë marrëdhëniet e tyre me botën dhe interesat e kësaj bote. Minimumi është një nivel ekuilibri. Kush do të përdorë, çfarë dhe sa, mund të dihet vetëm në kushtet e tij. Kriteri është i qartë: Asnjë mirësi e kësaj bote nuk duhet të shndërrohet në qëllim. Mirësitë janë mjete për të arritur qëllimin tonë kryesor në këtë botë ku jemi të përkohshëm. Nëse mjete zëvendësohet me qëllimin, thjeshtësia prishet.

Arti i të jetuarit si mysliman është një horizont shpirtëror me thjeshtësinë në qendër. Ai që dëshiron ta arrijnë këtë horizont, i minimizon lidhjet e tij me mjetet materiale, i përdor siç duhet ato që janë legjitime dhe vendos axhendën shpirtërore në qendër të jetës së tij. Atë jetë nuk e orientojnë kënaqësitë fiziko-materiale, por kënaqësitë shpirtërore. Një jetë e orientuar nga kënaqësitë shpirtërore është një jetë në të cilën rekomandohet e vërteta, veprat e mira dhe durimi dhe thirrja e së cilës drejtohet kah Allahu (xh.xh.). Nisur nga ky këndvështrim, të jetosh thjeshtë është një përpjekje për të gjetur kuptimin e jetës përmes tevhidit dhe për t'u bërë më njerëzor duke zbuluar atë që kërkohet prej nesh përmes këtij kuptimi. Në një mënyrë apo tjetër, mund të shpresohet se do ta ketë më të lehtë kushdo që synon dhe hyn në këtë përpjekje, të takojë Zotin dhe të vërtetën me kalimin e kohës, sepse fatkeqësia e kohës dhe fitneja aktuale e njeriut janë të vendosura pikërisht përballë jetës së thjeshtë.

Një jetë e thjeshtë është një jetë pa israf (pa shpërdorime). Allahu (xh.xh.), e ka bërë të lejuar (hallall) ngrënien, pirjen dhe përfitimim nga të gjitha llojet e mirësive brenda kufijve të ligjshëm. Nuk është e drejtë e askujt që hallallin e Allahut ta bëjë haram dhe haramin e tij ta bëjë hallall.

Ata që i përcaktojnë kufijtë janë Allahu (xh.xh.) dhe i Dërguari i Tij (a.s.). Shprehja më e përgjithshme e këtyre kufijve është thjeshtësia. Thjeshtësi do të thotë të mos biesh në shpërdorim. Kurse israfi-shpërdorimi është çuarje dëm e mirësisë. Ai që e çon dëm mirësinë, e çon dëm veten, sepse harami ka ndëshkim, kurse hallalli ka llogari. Jeta e thjeshtë, përveç të qenët larg haramit, është një jetë në të cilën gjithçka e lejuar llogaritet me masat e ekonomisë, drejtësisë dhe maturisë. Çdo gjë ka një të drejtë dhe një kufi. Ai që ia jep hakun gjithçkaje dhe e njeh kufirin e tij, gjen ekuilibrin. Kurani Fisnik e shpreh këtë me fjalën vasat/mesatar. «Vasat» do të thotë të jesh mesatar dhe të mos biesh në ekstrem, gjë e cila shprehet më së miri në ajetin vijues: **“dhe ata (robërit e mirë) që, kur shpenzojnë, nuk janë as dorëshpuar, as dorështrënguar, por i përmbahen të mesmes.”** (Furkan, 67)

Përmbajtja




8

Udhëzues për qëndrimin
ndaj mirësive
Dr. Adem Ergyl



Thjeshtësia është fisnikëri
Dr. A. Hamdi Jëllderëm

12




18



24

Lokman Hakimi - 1
Osman Nuri Topbash

- 5 Një jetë e thjeshtë është domosdoshmëri e besimit tonë
Mehmet Lutfi Çakan
- 10 Qëndrimi i sahabëve ndaj kësaj bote
Prof. dr. Sulejman Derin
- 14 Pse e kemi braktisur jetën e thjeshtë?
Ali Khan
- 16 Të bëhesh mbeturinë?
Apo të mbetesh njeri?
Halit Serhan Erxhivelek
- 18 Ilaçet e zemrës janë pesë
Prof. dr. Vahid Goktash
- 20 Suneti i vlerësimit të njerëzve
Ajdin Bashar



36

- Kushti më i rëndësishëm i lutjes 21
është kafshata hallall
M. Sami Ramazanollu
- Profeti (a.s.) dhe fëmijët 22
Sadik Dana
- Fetarizmi i integruar me dashuri dhe adhurim 30
Ali Riza Temel
- Harami ka ndëshkim, hallalli ka llogari 34
Abdullah Sert
- Kushdo që të vijë është i përkohshëm 36
Bestami Jazgan
- Mirë se erdhët pushimet e verës! 38
Prik. Tuba Sëkmen

32

Të jesh mirënjohës
ndaj Zotit (xh.xh.)
Omer Çelik



Një jetë e thjeshtë është domosdoshmëri e besimit tonë

— Mehmet Lutfi Arslan —

Vepra më efektive që do të na mundësojë të bëjmë një jetë të thjeshtë është meditimi. Çdo gjë që kalon, mbaron, priset dhe zhduket, ose përfundon duke u shkatërruar, është një shenjë që na kujton përkohshmërinë tonë. Ai që jeton thjeshtë është një njeri që nuk e ndan kurrë nga mendja pyetjen: “Çfarë pune kam unë me këtë botë?” - dhe nuk e harron kurrë qëllimin dhe destinacionin e tij kryesor.

Një beduin, i cili kishte dëgjuar se i Dërguari i Allahut (a.s.), kishte ardhur me fjalën “La ilahe il-lallah...”, kishte shprehur habinë e tij duke thënë: “Domethënë se do të ketë kundër tërë botën!”

“La ilahe il-lallah...” është shprehja e tevhidit, kurse tevhidi është çelësi i enigmës së quajtur dynja. Tevhidi është ilaçi për pështjellimin e botës në kuptimin e referimit të çdo qenieje, sjelljeje dhe vepre te Zoti (xh.xh.). Shërimi është në thjeshtësi. Nisur nga ky aspekt, tevhidi është mishërimi i thjeshtësisë. Ai që e adopton tevhidin si një mënyrë jetese, arrin t’i mbijetojë kësaj bote, e cila është një botë shumice dhe konfuzioni.

Tevhidi është adresa e thjeshtësisë, kurse kjo botë është adresa e pompozitetit. Tevhidi është një qëndrim i pastër, i dëlirë dhe i kristaltë, kurse çdo mënyrë jetese jashtë tevhidit është një rrëmujë që i tërheq njerëzit në moçal. Thjeshtësia është tipari dallues i jetës me tevhid dhe jetës pa tevhid. Ajo që të çon te e vërteta është e qartë dhe e dukshme, kurse ajo që të çon në gënjeshtër është komplekse dhe e pompozuar. E vërteta është e thjeshtë, kurse e gabuara është komplekse. E vërteta të shpëton, kurse e gabuara të fundos: “**..Ti thuaj Allahu, kurse ata lëri të qëndrojnë në batakun ku janë zhytur.**” (En’am, 91)

Thjeshtësia që na mëson tevhidi pasqyrohet në jetë përmes sunetit të Pejgamberit (a.s.). Jeta e të Dërguarit të Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, është një jetë shembullore me të cilën mund të përshkruhet vetë thjeshtësia. Profeti (a.s.), edhe pse kishte mundësi, ishte i kënaqur me pak, nuk i jepte rëndësi asnjëherë të shumtës, gjithnjë donte furnizim të mjaftueshëm për veten dhe familjen e tij dhe e konsideronte varfërinë në kuptimin e nevojës vetëm për Allahun dhe jo për



askënd tjetër, si nderin më të madh. Maksimat e mëposhtme janë shprehjet më të bukura të këtij konsiderimi: *“O biri i Ademit, është më mirë për ty që ta shpenzosh atë që të tepron. Nëse e mban atë, kjo është e keqe për ty. Nëse mban aq sa të nevojitet, nuk kritikohesh. Fillo të shpenzosh së pari me ata që i ke nën përgjegjësi për t’u kujdesur.”* (Tirmidhi, Zuhd, 32.)

Jeta e thjeshtë e vënë në dukje nga tevhidi dhe suneti është një jetë me një qëllim të caktuar që në fillim. Ai që e fokuson zemrën, mendjen dhe jetën në një pikë të vetme, do të fitojë. Ajo pikë është kënaqësia e Allahut (xh.xh.). Ne i përcaktojmë të gjitha marrëdhëniet tona, punët tona, ardhjet tona, ikjet dhe mendimet tona, madje edhe kur e ngremë gotën dhe e vendosim diku tjetër, vetëm për hir të Allahut. Të bësh shumë punë, të hysh e të dalësh nga shumë vende nuk është ndonjë gjë e madhe. Çështja është aftësia për ta lidhur gjithçka me Allahun (xh.xh.). Një jetë e thjeshtë ka si përparësi fitimin e kënaqësisë së Zotit, i Cili na ka krijuar. Ata që ndjekin këtë rrugë minimizojnë marrëdhëniet e tyre me botën dhe interesat e kësaj bote. Minimumi është një nivel ekuilibri. Kush do të përdorë, çfarë dhe sa, mund të dihet vetëm në kushtet e tij. Kriteri është i qartë: Asnjë mirësi e kësaj bote nuk duhet të shndërrohet në qëllim. Mirësitë janë mjete për të arritur qëllimin tonë kryesor në këtë botë ku jemi të përkohshëm. Nëse mjete zëvendësohet me qëllimin, thjeshtësia priset.

Arti i të jetuarit si mysliman është një horizont shpirtëror me thjeshtësinë në qendër. Ai që dëshiron ta arrijnë këtë horizont, i minimizon lidhjet e tij me mjetet materiale, i përdor siç duhet ato që janë legjitime dhe vendos axhendën shpirtërore në qendër të jetës së tij. Atë jetë nuk e orientojnë kënaqësitë fiziko-materiale, por kënaqësitë shpirtërore. Një jetë e orientuar nga kënaqësitë shpirtërore është një jetë në të cilën rekomandohet e vërteta, veprat e mira dhe durimi dhe thirrja e së cilës drejtohet kah Allahu (xh.xh.). Nisur nga ky këndvështrim, të jetosh thjeshtë është një përpjekje për të gjetur kuptimin e jetës përmes tevhidit dhe për t’u bërë më njerëzor duke zbuluar atë që kërkohet prej nesh përmes këtij kuptimi. Në një mënyrë apo tjetër, mund të shpresohet se do ta ketë më të lehtë kushdo që synon dhe hyn në këtë përpjekje, të takojë Zotin dhe të vërtetën me kalimin e kohës, sepse fatkeqësia e

kohës dhe fitneja aktuale e njeriut janë të vendosura pikërisht përballë jetës së thjeshtë.

Një jetë e thjeshtë është një jetë pa israf (pa shpërdorime). Allahu (xh.xh.), e ka bërë të lejuar (hallall) ngrënien, pirjen dhe përfitimin nga të gjitha llojet e mirësive brenda kufijve të ligjshëm. Nuk është e drejtë e askujt që hallallin e Allahut ta bëjë haram dhe haramin e tij ta bëjë hallall.

Ata që i përcaktojnë kufijtë janë Allahu (xh.xh.) dhe i Dërguari i Tij (a.s.). Shprehja më e përgjithshme e këtyre kufijve është thjeshtësia. Thjeshtësi do të thotë të mos biesh në shpërdorim. Kurse israfi-shpërdorimi është çuarje dëm e mirësisë. Ai që e çon dëm mirësinë, e çon dëm veten, sepse harami ka ndëshkim, kurse hallalli ka llogari. Jeta e thjeshtë, përveç të qenët larg haramit, është një jetë në të cilën gjithçka e lejuar llogaritet me masat e ekonomisë, drejtësisë dhe maturisë. Çdo gjë ka një të drejtë dhe një kufi. Ai që ia jep hakun gjithçkaje dhe e

njih kufirin e tij, gjen ekuilibrin. Kurani Fisnik e shpreh këtë me fjalën vasat/mesatar. «Vasat» do të thotë të jesh mesatar dhe të mos biesh në ekstrem, gjë e cila shprehet më së miri në ajetin vijues: **“dhe ata (robërit e mirë) që, kur shpenzojnë, nuk janë as dorëshpuar, as dorështrënguar, por i përmbahen të mesmes.”** (Furkan, 67)

Vepra më efektive që do të na mundësojë të bëjmë një jetë të thjeshtë është meditimi. Çdo gjë që kalon, mbaron, priset dhe zhduket, ose përfundon duke u shkatërruar, është një shenjë që na kujton përkohshmërinë tonë. Sapo fillojmë t’i shohim shenjat, kuptojmë se jemi transferuar nga një vend në një vend tjetër dhe arrijmë të konceptojmë faktin se domosdoshmëria e këtij udhëtimi është të mos orvatemi. Të mos orvatesh do të thotë të bësh një jetë të thjeshtë. Ai që bën një jetë të thjeshtë është ai që nuk e nxjerrë kurrë nga mendja pyetjen: “Çfarë pune kam me këtë botë?!” - dhe që nuk e harron asnjëherë qëllimin dhe destinacionin e tij kryesor. Kriteri është arritja e paqes dhe begatisë së të dy botëve sipas lutjes: “O Zoti ynë, na jep lumturi në këtë botë, na jep lumturi në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimi i xhehemit!” Bota tjetër është horizonti ynë kryesor, kurse kjo botë është vendi ynë i përkohshëm ku kërkojmë pjesën tonë. Jeta e thjeshtë është e pranueshme dhe e vlefshme aq sa na afron me horizontin tonë dhe na siguron lumturinë në të dyja botët.

NJË JETË E THJESHTË
KA SI PËRPARËSI FITIMIN
E KËNAQËSISË SË ZOTIT, I CILI NA KA
KRIJUAR. ATA QË NDJEKIN KËTË RRUGË
MINIMIZOJNË MARRËDHËNIET E TYRE ME
BOTËN DHE INTERESAT E KËSAJ BOTE.
KRITERI ËSHTË I QARTË: ASNJË MIRËSI E
KËSAJ BOTE NUK DUHET TË SHNDËRROHET
NË QËLLIM. MIRËSITË JANË MJETE PËR TË
ARRITUR QËLLIMIN TONË KRYESOR NË KËTË
BOTË KU JEMI TË PËRKOHSHËM. NËSE
MJETI ZËVENDËSOHET ME QËLLIMIN,
THJESHTËSIA PRISHTET.



Një jetë e thjeshtë është një jetë në qendër të së cilës gjendet mjaftimi me atë që ka dhënë Zoti (xh. xh.). Të mjaftohesh me këtë do të thotë të mos kesh nevojë për askënd tjetër përveç Allahut (xh.sh.). Të mjaftohesh me këtë do të thotë t'i shohësh që të gjithë të përkohshëm dhe të varfër, të shohësh vetëm dhe vetëm Zotin si të pasurin e vërtetë, dhe bazuar në këtë aspekt, t'i vlerësosh të përkohshmit vetëm aq sa përkohshmëria e tyre. Të mos kesh nevojë për askënd është parimi bazë. Çfarë mirësie e madhe është që njeriu të mos jetë barrë për askënd në këtë botë dhe të ngrejë gjithmonë barrë të tilla! Këshilla: “Mos iu bëj barrë asnjë njeriu qoftë edhe sa një pendë, biri im!”, është kurora e kokës dhe ilaçi i zemrave tona.

Një përfitim tjetër i mjaftimit me këtë është thjeshtësia që sjell në marrëdhëniet tona me njerëzit. Kjo gjendje gjithmonë e mbron cilësinë e lidhjes që krijohet me të tjerët, e qartëson qëllimin dhe unifikon bashkëbiseduesin. Sepse e di që fakti se me kë kontaktojmë dhe pse, është tregues i cilësisë dhe qëndrueshmërisë sonë. Studimet e bëra kanë treguar se ata, miqtë më të ngushtë të të cilëve janë obezë, kanë më shumë se 50% gjasa të jenë obezë. Shprehja: «Më trego shokun tënd, të të them se kush je.», është e famshme. Ndërkohë, një nivel përpara kësaj shprehjeje është lidhja e shokut me fatin. Shokët tanë janë fati ynë.

Çështja më e rëndësishme për ata që mbajnë thjeshtësinë në marrëdhënie është marrëdhënia e tyre me teknologjinë. Në ditët e sotme teknologjia po derdh mbi ne shumicën e informacionit të padobishëm të krijuar nga marrëdhëniet artificiale, axhendat dhe qarqet, të cilat i ekspozojnë mendjet dhe zemrat tona ndaj një kontaminimi të heshtur. Informacioni që nuk na nevojitet është një barrë. Grupet e tepërta dhe mesazhet e padobishme mjeçullojnë dallimin midis fushës së ndikimit tonë dhe fushës së interesave tona. Shumëllojshmëria dhe teprica e panevojshme e asaj që arrijnë ato, na kthejnë në tipa të pafuqishëm që nuk kanë kohë të bëjnë gjërat që mund t'i bëjnë. Kjo rutinë, e mbushur me informacione komplekse, të detajuara dhe të panevojshme, të cilat e prishin thjeshtësinë, i shndërron mendjet dhe zemrat tona në kosh mbeburinash informacioni, na e rrëmben vetëdijen dhe na kalb ndjeshmëritë dita-ditës.

Sot, thirrjet për ta bërë jetën të thjeshtë nën emrin e minimalizimit po shfaqen si përpjekje për të shpëtuar nga bota kapitaliste, e cila i kodon njerëzit të konsumojnë më shumë nderin dhe dinjitetin e tyre. Shumica e propozimeve për të jetuar thjeshtë janë kode natyrore të të jetuarit si mysliman. Jeta e thjeshtë, në thelb, është një mënyrë jetese që i

Dërguari i Allahut (a.s.), nuk e braktisi kurrë, një domosdoshmëri e tevhidit dhe besimit. Jeta e thjeshtë, e cila shfaqet si stil jete për ne në ditët e sotme, nuk është alternativë ndaj kapitalizmit brutal, është gjendja jonë e natyrshme që duhet ta preferojmë kundrejt kësaj bote.

Një jetë e bazuar vetëm në konsum nuk ka kuptim. Urdhri «për t'u mbrojtur nga zjarri i xhehenimit qoftë edhe me një gjysmë hurme», i jep mundësinë edhe njeriut më të varfër të bëjë infak (të japë për hir të Allahut), si rrjedhojë i jep horizontin e produktivitetit. Edhe paralajmërimi «të paktën mos bëj keq» për ata që thonë se nuk mund të bëjnë asnjë mirësi, këshillon të zgjedhin anën e tyre me një logjikë të ngjashme. Ana jonë është ana e mirësisë, e atyre që përpiqen për mirësi dhe që përpiqen që ditën e tyre ta bëjnë më produktive dhe më të mirë se ditën më parë, duke pyetur vazhdimisht “çfarë bëra sot për Allahun”. Këtu në plan të parë është përpjekja për të prodhuar, jo për të konsumuar, për të futur gëzim në zemrat e njerëzve dhe për të bërë vepra përkujtimore duke vlerësuar momentin.

Ne kemi ardhur në këtë botë për të jetuar thjeshtë dhe e bëjmë këtë si domosdoshmëri e besimit tonë. Nisur nga ky aspekt, duke konsumuar më pak dhe duke u kënaqur me më pak, nuk kemi asgjë për të mësuar nga ata që përpiqen të shpëtojnë nga një botë ndërkohë që janë skllëvër të saj. Shpresohet se ajo që kërkojnë këta njerëz, të cilët ndjekin britmat e ndërgegjes së tyre, të jetë e dobishme për udhëzimin e tyre. Ajo që shpresohet është që, njerëzit që pandehet se janë në rrugë të drejtë ta përmbushin domosdoshmërinë e besimit të tyre. Ndërkohë që është e qartë mënyra e jetesës së Profetit (a.s.), të cilin duhet ta duam më shumë se çdo gjë, nëse bëjmë një jetë pa masë luksoze dhe pompoze, është ashikare se llogaria jonë do të jetë e rëndë. Një jetë e thjeshtë është domosdoshmëri e besimit tonë.



Udhëzues për qëndrimin ndaj mirësive

— Dr. Adem Ergyl —

Përfitimi nga të gjitha llojet e mirësive nuk mund të dënohet. Megjithatë, edhe ky përfitim ka kufijtë dhe edukatën e tij. Disa nga këto kritere janë që të mos llastohemi me këto mirësi, të mos shfaqim superioritet ndaj të tjerëve me to, të mos mbështetemi te mirësitë, të mjaftohemi me sasinë e mjaftueshme që na nevojitet dhe të bëjmë një jetë modeste pa rënë në luks e shpërdorim dhe me një ndjenjë mirënjohjeje ndaj Allahut (xh.xh.).

Në vend që t'i renditim mirësitë e Zotit të Madhëruar në formën «të vogla-të mëdha», ndoshta do të ishte më e përshtatshme që çdo mirësi të Tij ta konsideronim si të madhe. Sepse, megjithëse fjala «e vogël» ka shumë kuptime në varësi të vendit ku përdoret, ajo gjithashtu mund të mbartë një kuptim negativ kur përdoret krahas për krahas me mirësinë. Dijetarët dhe të urtët tanë kanë disa rregulla edukate për qëndrimin e jashtëm dhe të brendshëm të një besimtarit kundrejt mirësive të Zotit (xh.xh.). Ne këtu nuk do t'i theksojmë të gjitha dimensionet e një çështjeje të tillë, për të cilën janë shkruar libra me vëllime. Ne këtu do të mjaftohemi duke tërhequr vëmendjen për disa nga këto rregulla edukate.

Çdo mirësi e Zotit (xh.xh.), është e çmuar dhe është dhënë që robërit e Tij të përfitojnë prej saj. Nuk bëhet fjalë që një besimtar i cili ka prioritet jetën e përqendruar në botën tjetër, të privohet nga begatitë e kësaj bote. Duke iu drejtuar të Dërguarit

të Tij, Zoti i Plotfuqishëm tërheq vëmendjen për këtë marrëdhënie të ndjeshme siç vijon:

“Thuaj: “Kush i ka penguar stolitë dhe ushqimet e këndshme, të cilat Ai i ka krijuar për robërit e Vet?” Thuaj: “Ato janë për besimtarë (dhe të tjerët) në këtë botë, ndërsa në botën tjetër do të jenë vetëm për besimtarët. Kështu ua shpjegojmë shpalljet njerëzve që dinë.» (A'raf; 32)

Përfitimi nga të gjitha llojet e mirësive nuk mund të dënohet. Megjithatë, edhe ky përfitim ka kufijtë dhe edukatën e tij. Disa nga këto kritere janë që të mos llastohemi me këto mirësi, të mos shfaqim superioritet ndaj të tjerëve me to, të mos mbështetemi te mirësitë, të mjaftohemi me sasinë e mjaftueshme që na nevojitet dhe të bëjmë një jetë modeste pa rënë në luks e shpërdorim dhe me një ndjenjë mirënjohjeje ndaj Allahut (xh.xh.).

Ata që e vendosin veten mbi robërit e tjerë të Allahut duke e parë gjendjen për nga grada, pozita, pasuria, dituria e madje edhe urtësia si mjet superioriteti, nuk janë pranuar në asnjë mënyrë, madje njerëzit e tillë nuk konsiderohen të denjë për mirësitë e ahiretit. Ajeti i mëposhtëm, i cili përmendet pas skenës së shkatërrimit të Karunit, i cili u llastua për shkak të pasurisë së tij, është jashtëzakonisht shumë domethënëse në këtë kontekst:

“Ja vendbanimi i botës tjetër: Ne ua japim atë atyre që nuk duan të mburren dhe të bëjnë prishje

në tokë. Rezultati (i bukur) është për ata që kanë frikë (nga mëkatet).” (Kasas, 83)

Fjala (علو/uluv) e përkthyer si mburrje është e jashtëzakonshme. Uluv do të thotë të jesh arrogant (të mburrësh) ndaj të vërtetave që vijnë nga Zoti dhe ndaj krijesave dhe t'i kalosh kufijtë në vepra. Në interpretimin e këtij ajeti, Ibn Kethiri, citon një thënie nga Aliu, kerremall-llahu vexhhehu:

“Nëse një njeri dëshiron që lidhësja e këpucëve të tij të jetë më i mirë se lidhësja e këpucëve të shokut të tij dhe ai e pëlqen këtë, ai njeri gjithashtu përfshihet në kategorinë «e atyre që duan uluv» të përmendur në këtë ajet.”

Edhe pse për disa mund të duket si një masë ekstreme, është një deklaratë e rëndësishme për atë që tregon se as edhe një grimcë mburrjeje dhe arrogance nuk duhet të lejohet të jetojë në zemrën e një besimtari.

Natyrisht, askush nuk mund ta bëjë haram atë që Allahu e ka bërë hallall. Mirëpo, nëse nuk merren parasysh rregullat dhe kufijtë, mund të formohen gjendje të tilla si mendjemadhësia, e cila ndonjëherë mund të ndodhë me njerëzit që fitojnë në hallall. Kjo gjendje mund ta çojë njeriun në humbje dhe të shndërrohet në një mjet që e zvarrit njeriun drejt xhehenemit. Për këtë arsye, ishte ndër rekomandimet e të Dërguarit të Allahut (a.s.), për umetin e tij që të preferonin një gjendje të moderuar në të ngrënë, pirë, veshje, në shtëpi, në makinë dhe në shumë çështje të tjera dhe të bënin një jetë të thjeshtë.

Të qenët i përlur në mirësi është diçka që mund ta arrijnë vetëm ata që e njohin kufirin dhe edukatën ndaj Zotit (xh.xh.). Kur bëhet fjalë për arritjen e mirësive, materiale apo shpirtërore qofshin ato, është e vështirë të qëndrosh pa u kapluar nga ndjenja “uluv”, të jesh i natyrshëm pa e sforcuar veten dhe të bësh një jetë të thjeshtë. Kur të mendohen krahu për krahu të gjitha hijeshitë e kësaj bote dhe lakmitë e epshet e pangopura të nefsit, kjo vështirësi sigurisht që shtohet edhe më shumë. Ndërsa ka stimuj dhe provokime të brendshme dhe të jashtme midis të afërmve dhe moshatarëve, është vërtetë e vështirë të ruash një stil jetese modest dhe të thjeshtë brenda mundësive ekzistuese pa rënë në koprraci. Prandaj nganjëherë thuhet se është më e vështirë të fitosh sprovën në pasuri sesa në varfëri.

Disa nga nënat tona,

të cilat ishin bashkëshorte të të Dërguarit të Allahut, kërkuan disa gjëra nga ai në lidhje me begatitë dhe stilitë e kësaj bote. Nisur nga kjo, zbriti ajeti vijues:

“O pejgamber! Thuaju bashkëshorteve të tua: “Nëse doni jetën dhe bukuritë e kësaj bote, më lejoni t’ju jap diçka dhe pastaj t’ju lë të lira me mirësi. Por nëse doni Allahun, të Dërguarin e Tij dhe vendbanimin e botës tjetër, dijeni se Allahu ka përgatitur shpërbllim të madh për ata prej jush që zgjedhin mirësinë.” (Ahzab 28-29)

Nënat tona të nderuara, sapo zbriti ky ajet fisnik, të gjitha treguan preferencat e tyre duke thënë se nuk do ta ndërronin Allahun dhe të Dërguarin e Tij me asgjë. Po, qëndrimi asket i atyre që janë në krye përballë kësaj bote dhe mirësive të saj sigurisht që është shumë më i rëndësishëm se i të tjerëve.

Konsiderimi i mirësive si një sprovë dhe mundësi mirënjohjeje ndaj Zotit, konsiderimi i tyre si bekime të Zotit duke pasur respekt ndaj tyre dhe t’i mbështetesh vetëm Zotit, në vend që të mbështetesh te ato, dhe të mos bësh vlerësime të gabuara si konsiderimi nder i dhënies së tyre dhe konsiderimi i vetes si e pavlefshme te Zoti në rastin e marrjes së tyre, është një qëndrim prej besimtari që e dëshiron Zoti i plotfuqishëm.

Të mbështetesh te këto bekime vetëm për të mirën tënde, pa i ndarë me askënd, dhe më keq akoma, t’i konsiderosh ato nga nderi yt ose të kesh ndjenjën djallëzore se «unë jam më i mirë dhe më i lartë se ai tjetri» duke u kapluar nga iluzioni se je më lart se të tjerët falë atyre mirësive, do të thotë të humbasësh ndërsa duket se ke fituar.

Të mos i hyjnizosh mirësitë dhe të mos bëhesh rob i tyre, apo thënë me fjalë të tjera, të mos biesh në dashuri me to, por të përfitosh prej tyre dhe t’i ndash ato me robërit e Allahut Teala me një pjekuri modeste dhe të thjeshtë pa rënë në luks dhe shpërdorime, është një dhuratë e mrekullueshme e Zotit (xh.xh.).





Qëndrimi i sahabëve ndaj kësaj bote

— Prof. dr. Sulejman Derin —

Profeti ynë i dashur (a.s.), bëri një jetë të thjeshtë gjatë gjithë jetës së tij, duke veshur çdo gjë që mund të gjente, prej leshi dhe pambuku, me ose pa arna. I qepte vetë opingat dhe i arnonte vetë rrobat e tij dhe i milte vetë dhitë e dhentë. Nganjëherë flinte mbi qilim, nganjëherë mbi rrogaz. Hante kur gjente dhe e bënte nijet të agjëronte kur nuk gjente.

Kjo botë është ara e botës tjetër, domethënë është një mjet, jo një qëllim. Allahu i Madhëruar na ka mbushur me begati në këtë botë me bujarinë e Tij. Ata që i përdorin këto begati në rrugën e Allahut do të shpërblehen me mirësi më të bukura që nuk mund të imagjinohen në botën e përtejme. Si kundër kësaj, ata që e përdorin këtë botë vetëm për veten e tyre, do të jenë të privuar në botën tjetër. Për t'i arritur mirësitë e përjetshme, është e nevojshme që mirësitë e përkohshme të sakrifikohen siç urdhërohet nga feja jonë. Për këtë duhet që njeriu të jetojë thjeshtë dhe të shmanget nga luksi. Profeti (a.s.), duke thënë: «Thjeshtësia është prej besimit.», i ka këshilluar besimtarët që të largohen nga shpërdorimi dhe shtirja. Fjala «bezaze» që përmendet në hadith dhe që përkthehet si thjeshtësi, do të thotë të konsumosh pak, të mjaftohesh me nevojat e detyrueshme dhe të mos e teprosh në veshmbathje.

Profeti ynë i dashur (a.s.), bëri një jetë të thjeshtë gjatë gjithë jetës së tij, duke veshur çdo gjë që mund të gjente, prej leshi dhe pambuku, me ose pa arna. I qepte vetë opingat dhe i arnonte vetë rrobat e tij dhe i milte vetë dhitë e dhentë. Nganjëherë flinte mbi qilim, nganjëherë mbi rrogaz. Hante kur gjente dhe e bënte nijet të agjëronte kur nuk gjente. Një

ditë, rrogazi në të cilin flinte i la gjurmë në fytyrë. Sahabëve që i thanë: “Sikur të kishe hedhur diçka mbi rrogaz!”, ai iu përgjigj: “Çfarë pune kam unë me dynjanë? Unë jam si një udhëtar që merr një hije nën një pemë gjatë udhëtimit të tij në këtë botë dhe pastaj kalon.» (Ibn Maxhe, Zuhd, 409.)

Edhe sufitetë që ndoqën rrugën e Pejgamberit (a.s.), bënë një jetë të thjeshtë. Ata e panë se jeta e kësaj bote në përgjithësi i preokupon shumë njerëzit, madje se i mashtron të shkujdesurit, dhe në përputhje me këtë, ata inkurajuan «zuhdin/asketizmin», që do të thotë të qëndrosh larg nga gjërat boshe të kësaj bote. Sipas imam Rabbanit jetë e thjeshtë/zuhd/asketizëm do të thotë “të mjaftohesh me nevojat thelbësore dhe t'i minimizosh sa më shumë të lejuarat. Në Mektubat këtë çështje e shpjegon si më poshtë:

“O bir! Çështja kryesore është të shmangësh teprimin në të lejuarat dhe të mjaftohesh me sasinë e nevojës. Edhe këtë duhet ta bësh me qëllimin për të fituar forcë, në mënyrë që të përmbushësh detyrën e robërisë ndaj Zotit (xh.xh.).

Për shembull, qëllimi nga të ngrënët është të fitosh forcë dhe fuqi për t'iu bindur Allahut Teala. Qëllimi nga veshja është mbulimi i vendeve të turpshme dhe mbrojtja nga të ftohtit dhe të nxehtit. Në këtë mënyrë duhet të vlerësohen edhe gjërat e tjera të lejuara e të nevojshme.” (Vëll. I, Letra e 73-të.)

Pa dyshim, nevoja ndryshon sipas kohës dhe vendit. Një njeriu që jeton në qytet nuk i takon ta lërë familjen e tij në gjendje të vështirë me mendimin

se do të bëj një jetë askete. Megjithatë, nuk është punë e një myslimani të mençur që ta kalojë tërë jetën duke rendur pas gjërave të panevojshme dhe të marrë hua për të blerë çdo gjë të nevojshme dhe të panevojshme. Shumë njerëz kanë bërë dasma të bukura dhe më pas janë lodhur duke paguar borxhet e tyre për vite me radhë. Shumë familje po shkatërrohen për shkak të shpenzimeve dhe huamarrjeve të panevojshme. Në fakt, epidemia e koronës tregoi se dasmat dhe ceremonitë tona mund të bëhen më thjeshtë dhe më lirë.

Pse të mos jetë e mundur të martohesh pa borxhe dhe me një martesë të thjeshtë në kohë normale si në periudhën e epidemisë? Duke i shtuar këta shembuj, mund të gjejmë mënyra për ta bërë më të thjeshtë jetën tonë. Sidomos ata që i bashkohen tarikatit dhe dëshirojnë të përparojnë në rrugën e spiritualitetit duhet të jenë më të kujdesshëm në këtë çështje:

Imam Rabbani ka rekomanduar që njohësit e tarikatit të jenë të palëkundur, t'i braktisin lejetimet dhe të qëndrojnë larg haramit dhe gjërave të dyshimta. Në fakt, kur shikojmë historinë e Islamit, sahabët me në krye të Dërguarin e Allahut (a.s.), bënë sakrificë edhe me nevojat e tyre thelbësore, e lëre më me gjërat e lejuara. Asketët si Ibrahim ibn Edhemi dhe Sekiki Belhi të cilët ndiqnin këtë gjendje të Profetit (a.s.), ua kanë kthyer shpinën stolive mashtruese të kësaj bote dhe të gjitha mundësitë e tyre i kanë përdorur për besimtarët.

Kur vijmë në ditët e sotme, shohim se njerëzimi është lodhur nga ndjekja e materies, kënaqësisë dhe shpejtësisë dhe po kërkon një rrugëdalje për veten. Njerëzit perëndimorë po përpiqen të gjejnë mënyra për të shpëtuar nga zgjedha e materies dhe për të bërë një jetë të thjeshtë me një stil jetese të quajtur minimalizëm në ditët e sotme. Kjo lëvizje, e cila nisi si pastrimi i shtëpive nga sendet e panevojshme dhe reduktimi i shpenzimeve të tilla, vazhdon të rritet dhe bëhet gjithnjë e më popullore çdo ditë që kalon. Në fakt, ne nuk kemi nevojë për filozofi/mënyra jetese të tilla të mbira në mënyrë të menjëhershme, sepse sufijtë kanë rekomanduar prej shekujsh që të mjaftohemi me pak në çdo aspekt, duke thënë: "Kil-leti taam, kil-leti kelam, kil-leti menam, pra, konsumo pak, fol pak, fli pak."

Megjithatë, disa nga vëllezërit tanë dëshirojnë të përfitojnë nga mirësitë e kësaj bote me kusht që të jenë hallall dhe janë të kënaqur që kanë më të mirën nga çdo gjë. Nuk mund të flitet për myslimanë të tillë që duan të jetojnë me lejet, me kusht që të

fitojnë hallall dhe të japin zekatin e tyre, sepse gjëja kryesore në Islam është fetvaja, andaj askush nuk mund të detyrohet për devotshmëri. Sidomos në Nakshibendizëm, parimet «halvet der enxhymen, dora me fitimin, zemra me Zotin», na bëjnë të mundur një thjeshtësi të ekuilibruar. Në fakt, i ndjeri Hoxha Musa Topbashi ishte jashtëzakonisht bujar me ata që e rrethonin dhe bënte një jetë mjaft ekonomike në çështjet e tij personale. Po ashtu, i ndjeri Sami Topbashi, si trashëgimtar i principatës Ramazano-gullari, nuk zgjodhi të bënte një jetë të pasur ndërsa kishte mundësi dhe bëri një jetë të thjeshtë duke refuzuar një trashëgimi të madhe.

Për të qenë të sinqertë, jo të gjithë e kanë të mundur të jenë si i Dërguari i Allahut (a.s.), ose si Ibrahim ibn Edhemi. Në këtë drejtim, ne mund të gjejmë gjerësinë që kërkojmë në jetën e sahabëve, sepse ata janë si yjet në qiell, sipas përshkrimit të Profetit (a.s.), cilindo që të ndjekim, do të shpëtojmë. Ne shohim se ata kanë pasur katër rrugë të ndryshme në qëndrimin e tyre ndaj kësaj bote:

Ebu Bekri (r.a.), është shembulli i atyre që jetojnë në kulmin e jetës së thjeshtë duke dhënë në rrugë të Allahut Teala të gjithë pasurinë e tij. Omeri (r.a.), është shembulli i atyre që jetojnë me një thjeshtësi të mesme duke e sakrifikuar gjysmën e pasurisë së tij në rrugën e Islamit. Kurse Osmani (r.a.), është në krye të atyre të pasurve që e mbledhin pasurinë për hir të Allahut (xh.xh.) dhe që e harxhojnë atë me bujari kur t'i vijë koha e duhur. Në krye të atyre që u larguan nga dynjaja edhe pse ajo u shkoi me vrap, dhe iu dhanë diturisë, edukimit të njerëzve dhe xhihadit, është Aliu (r.a.). Te këta katër sahabë, të cilët janë më të afërt me Profetin (a.s.), ka shembuj të mirë që mund të zbatohen nga të gjithë ne. Pavarësisht qasjeve të tyre të ndryshme, të gjithë ata e konsideruan këtë botë si të përkohshme dhe botën tjetër si të përhershme. Kështu që jetën e kësaj bote e bënë një hap/shkallë drejt botës tjetër (ahiretit). Detyra jonë është të bëjmë zgjedhjen që i përshtatet më së miri natyrës sonë dhe caktimit të Zotit dhe të zgjedhim një jetë të thjeshtë sa më shumë që të jetë e mundur. Zoti na bëftë të suksesshëm në këtë çështje dhe mos na bëftë shkaktarë për rebelim të besimtarëve të tjerë për faktin se disa qarqe fetare kanë rëshqitur në një jetë të ekzagjeruar!

Amin!



THJESHTËSIA ËSHTË FISNIKËRI

— Dr. A. Hamdi Jëlldërëm —

Pasqyrimi i jashtëm i besimit te njeriu është thjeshtësia e tij. Thjeshtësi do të thotë të jesh i pastër dhe modest. Besimtar është ai njeri i cili beson se Allahu është Ai që i jep mirësitë. Ai e di se të shfaqësh mburrje kundrejt robërve të Allahut me mirësitë që ka dhënë Allahu është e pakuptimtë, madje se çon në humbjen e mirësive.

“O bijtë e Ademit, vishuni përshtatshëm kudo dhe kurdo që të faleni! Hani e pini, por mos e teproni, se Ai nuk i do ata që e teprojnë.” (A’raf, 31)

Ndërsa besimi i vërtetë përhap cilësi të mira dhe përsosmëri, hipokrizia, të cilën myslimani nuk duhet ta ketë, nxjerr në pah cilësi të këqija. Robi duhet të përpiqet që të jetë i devotshëm ndaj Allahut (xh.xh.), fshehurazi dhe publikisht. Gjëja kryesore është të arrijmë pëlqimin e Zotit (xh.sh.). Kjo jetë e dynjasë është dhënë si kapital për të fituar botën e përtejme. Duke pasur një periudhë të kufizuar kohore të quajtur jetë, njeriu duhet të përqendrohet në detyrën e tij kryesore, jo në punë të kota. Një mysliman nuk ka kohë të preokupohet me gjëra të kota. Kjo është arsyeja pse jeta e kësaj bote është një mjet, jo një qëllim, për një mysliman që është i përqendruar në synimin e tij.

Kur pikëpamja e myslimanit për botën të jetë nga korniza e «mjetit», edhe vlerësimi i tij për botën do të jetë me kuptimet që i atribuohen një mjeti. Në fakt, sahabi Ebu Umame, radijall-llahu anh, transmeton siç vijon:

Një ditë, sahabët e të Dërguarit të Allahut (a.s.) folën për këtë botë në praninë e tij. Nisur nga kjo, i Dërguari i Allahut (a.s.), u tha:

“A nuk dëgjoni? A nuk dëgjoni? Të jetosh thjeshtë është prej besimit. Të bësh një jetë të thjeshtë është nga besimi.” (Ebu Davud, Terexhxhul, 2.)

Të jetosh thjeshtë do të thotë të mos e shndërrosh këtë botë në qëllim, t’i atribuosh një vlerë kësaj bote me vetëdijen se ajo është një mjet dhe të veprosh sipas kësaj. Qëllimi dhe synimi është të jesh rob i vërtetë i Allahut. Për ta përmbushur këtë robëri, mund të përfitohet nga kjo botë aq sa është e nevojshme.

Kuptimi i përfitimit nga kjo botë aq sa është e nevojshme ndryshon sipas mjedisit (rrethanave) në të cilin ndodhet secili. E rëndësishme është që njeriu të përfitojë nga mirësitë e Allahut të Madhëruar në një mënyrë që të mos u nxisë zilinë njerëzve të tjerë.



Mirëpo, t'i provokosh njerëzit, t'i bësh të të kenë zili, t'i bësh të të kenë lakmi me të mirat e dhuruara nga Allahu dhe t'i kthesh ato të mira në një mjet epërsie ndaj tyre, janë gjëra që feja jonë i ndalon.

Nuk është problem që njeriu të konsumojë atë që i përshtatet atij dhe mjedisit të tij shoqëror ngaqë është cilësore dhe e qëndrueshme, përkundrazi kjo është sjellje që pritet nga myslimani. Kështu, Abdullah ibn Abbasi (r.a.), ka vendosur këtë rregullin e artë:

“Ha çfarë të duash, vish çfarë të duash! Mjafton të mos biesh në shpërdorim, mendjemadhësi dhe arrogancë!”

Allahu Teala dëshiron ta shohë mirësinë që e ka dhënë mbi robin e Tij. Megjithatë, Ai kurrë nuk lejon që kjo mirësi të bëhet një mundësi për t'u dukur dhe një mjet statusi diskriminues kundrejt të varfërve dhe nevojtarëve.

Njeriu i arsyeshëm përpigjet të ndërtojë ahiretin e tij, jo dynjanë e tij. Kurse ata që nuk janë të mençur e shohin këtë botë si qëllim. Prandaj thuhet se bota do të shkatërrohej po të mos ishin budallenjtë. Ndërsa ata e ndërtojnë këtë botë në të cilën nuk do të qëndrojnë, e shkatërrojnë ahiretin e tyre ku do të qëndrojnë përgjithmonë.

Nga ana tjetër, për njeriun që e konsideron pamjen e jashtme të tij si mjet mburrjeje dhe arrogance, Hz. Pejgamberi ka thënë:

“Një herë e një kohë, një burrë i vetëkënaqur po ecte, i veshur me rrobën e tij të bukur, me flokë të krehur dhe duke u mburrur. Allahu i Lartësuar e zhyti atë në fund të tokës. Ai njeri do të vazhdojë të të qëndrojë në fund të tokës duke u përpëlitur deri në Ditën e Gjykimit.” (Buhari, Libas, 5; Muslim, Libas 49, 50.)

Myslimani duhet t'i kushtojë rëndësi veshjes dhe pamjes së jashtme sa të mundet. Në fakt, kur i Dërguari i Allahut (a.s.), u fliste shokëve të tij se është e ndaluar mendjemadhësia/mburrja, sahabët e nderuar i thanë: «O i Dërguari i Allahut! Njeriut i pëlqen të ketë këpucë të bukura dhe të ketë rroba të bukura.» Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë (a.s.), u shpjegoi parimin bazë vijues: «Vërtet, Allahu është i bukur dhe e do bukurinë! Kurse mendjemadhësia është të mos pranosh të vërtetën dhe t'i shikosh njerëzit me përçmim.» (Muslim, Iman, 147.)

Është një situatë që lëvdohet, jo për t'u fajësuar, që një njeri, krijimi i të cilit është i bukur, të përpigjet

të duket bukur dhe t'i pëlqejë kjo për shkak të natyrshmërisë së tij. Profeti (a.s.), e ka shprehur këtë situatë duke thënë se “Allahu kënaqet ta shohë te rob i Tij mirësinë që ia ka dhënë”. (Shik. Tirmidhi, Edeb, 54.)

Kur hadithet e Profetit (a.s.), shtjellohen në tërësi, kuptohet se feja islame nuk e ndalon veshjen për nga cilësia dhe estetika, përkundrazi e inkurajon këtë. Ajo e ndalon rreptësisht që të shndërrohet në një mjet statusi dhe të përdoret me qëllim të poshtërimit dhe nënçmimit të të tjerëve, apo të përdoret si mjet për të fituar një reputacion ndërmjet të tjerëve. Nëse duhet ta përmbledhim, ajo që ndalohet është që njeriu të harrojë se është rob, të mburret me rrobat e tij dhe ta konsiderojë veten më të lartë se të tjerët, sepse ajo që i shkon robit është ta njohë robërinë e tij dhe të jetë modest.

Përveç kësaj, njeriu, i cili është i përbërë nga aspekti fizik dhe shpirtëror, pasqyron jashtë atë që ka brenda tij dhe brenda atë që ka jashtë tij. Pamja jonë e jashtme përmban të dhëna për botën tonë të brendshme. Bota e brendshme e njerëzve që përvetësojnë kultura jo-islame në mënyrën se si vishen dhe i përdorin gjërat, ndryshon tek ata me kalimin e kohës. Kjo është arsyeja pse mënyra jonë e jetesës gjithashtu zbulon identitetin tonë.


Pasqyrimi i jashtëm i besimit të njeriu është thjeshtësia e tij. Thjeshtësi do të thotë të jesh i pastër dhe modest. Besimtar është ai njeri i cili beson se Allahu është Ai që i jep mirësitë. Ai e di se të shfaqësh mburrje kundrejt robërve

të Allahut me mirësitë që ka dhënë Allahu është e pakuptimtë, madje se çon në humbjen e mirësive.

Myslimani është një njeri që u jep për të ngrënë të tjerëve prej asaj që ha vetë dhe u jep për të veshur të tjerëve prej asaj që vesh vetë. Ai nuk krijon hendek duke ndërtuar mure të larta mes vetes dhe njerëzve të tjerë. Përkundrazi, ai bën përpjekje për të ndarë mundësitë që posedon me të gjithë për të krijuar unitet dhe integritet.

Ashtu si përdorimi i mirësive të dhëna nga Allahu nuk mund të jetë mjet për të fituar një status, po ashtu është gabim të pretendohet për asketizëm dhe devotshmëri duke mos i përdorur mirësitë:

“Allahu nuk shikon pamjen dhe pasurinë tuaj, por shikon zemrat dhe veprat tuaja.” (Muslim, Birr, 34.)



Pse e kemi braktisur jetën e thjeshtë?

— Ali Khan —

PSE E KEMI BRAKTISUR JETËN E THJESHTË QË I BËN NJERËZIT TË QETË DHE NUK I SFORCON KUFIJTË E FUQISË SË TYRE NË FITIM DHE SHPENZIM? PËRVEÇ RRRITJES SË SENDEVE DHE MALLRAVE TË PËRPUNUARA NË KËTË BOTË, JEMI TË DETYRUAR TË BËJMË JETËN QË NA ËSHTË IMPONUAR NATYRISHT NËPËRMJET REKLAMIMIT DHE MARKETINGUT. MEGJITHATË, KA EDHE SHKAQE PSIKOLOGJIKE. NJËRI NGA SHKAQET ËSHTË NARCISIZMI NË NIVEL PERSONAL.

Pse e kemi braktisur jetën e thjeshtë e cila u jep njerëzve prehje dhe nuk i sforcon kufijtë e fuqisë së tyre në fitim dhe shpenzim? Krahas shtimit të sendeve dhe mallrave të përpunuara në botë, sigurisht që jemi detyruar të bëjmë jetën e imponuar me reklamat dhe marketingun e tyre. Megjithatë, ka edhe shkaqe psikologjike. Njëri nga shkaqet është narcisizmi në nivel personal.

Si të gjitha gjallesat, edhe njerëzit lindin nevojtarë. Është thelbësore të plotësohen këto nevoja, në mënyrë që ata të mbijetojnë. Me jetën moderne, qeniet njerëzore mendojnë se kanë nevojë për më shumë gjëra ose janë bërë të ndjehen të tillë. Mallrat dhe produktet që kanë pak ose aspak shërbim për njeriun zënë aq hapësirë në jetën tonë sa të tjerët. Ja pra, në momente të tilla, është përmendur një tipar i ri sjelljeje dhe qëndrimi i quajtur «jeta minimaliste», e cila pretendohet se përfaqëson pamjen e jetës dhe të gjërave në kuptimin e thjeshtësisë dhe modestisë.

Ky qëndrim dhe sjellje e re kanë të bëjnë thjesht me mbajtjen e gjërave të nevojshme dhe eliminimin e gjërave në jetën tuaj që nuk ju shërbejnë. Pretendimi është se me një jetë të qëllimshme të fokusuar në eliminimin e gjithçkaje të panevojshme, ju gjeni më shumë liri dhe kënaqësi sesa me një jetë të çrregullt, materialiste ose tepër të zënë. Kjo nuk ka të bëjë me të jetuarit në privim. Përkundrazi, është thjesht gjetja e gjërave më të rëndësishme që ju sjellin gëzim, paqe, rritje dhe produktivitet. Ka të bëjë me fokusimin në atë që është e rëndësishme kur bëhet fjalë për aktivitetet tuaja, mentalitetin tuaj, atë që keni dhe përdorimin e kohës suaj.

Zoti i Plotfuqishëm në ajete të ndryshme të Librit



të Tij thekson se do të sprovohemi me pasurinë dhe jetën, se i duam mallrat (gjërat) me pasion dhe lakmi për grumbullim dhe se ata që kanë mbetur janë të preokupuar me pasurinë dhe familjet e tyre. Ajeti i 20-të i sures Hadid në fakt përmbledh situatën e atyre që nuk i përdorin mirësitë e jetës në favor të thjeshtësisë. **“Dijeni se jeta e kësaj bote nuk është veçse një lojë, një shpërqendrim i pasionuar (argëtim), një stoli, një mburrje mes jush dhe një pasion për shumëfishimin e pasurisë dhe fëmijëve.”**

Shah Velijullah Dihleviu, në veprën e tij të titulluar Huxhxhetull-llah'il-Baliga, nën titullin «Të mësosh mënyrat për të plotësuar nevojat», shënon se Allahu Teala e ka frymëzuar njeriun se si t'i plotësojë nevojat e tij. Njeriu gjithmonë ndjen të njëjtën nevojë si njerëzit e tjerë në çështjet si ngrënia, pirja, marrëdhëniet seksuale, mbrojtja nga dielli dhe shiu, ngrohja ndaj të ftohtit në dimër dhe çështje të ngjashme me këto. Para së gjithash, orientimi i njeriut ndaj diçkaje për të plotësuar këto nevoja buron nga mendimi i përgjithshëm. Ndryshe nga kafshët, qeniet njerëzore mund të veprojnë në një mënyrë që ata mendojnë se do të jetë e dobishme pa një motiv natyror. Së dyti, njeriu kërkon edhe hirin dhe bukurinë në plotësimin e nevojave të tij. Ai gjithashtu dëshiron që sytë e tij të ndriçohen dhe shpirti i tij të kënaqet. Si rezultat i kësaj ai dëshiron bashkëshorte të bukur, ushqim të shijshëm, veshje cilësore dhe shtëpi luksoze. Së treti, njerëzit i gjejnë vetë mënyrat për të përmbushur nevojat e tyre ose i mësojnë duke imituar. Këto tri tipare nuk gjenden tek të gjithë njerëzit në mënyrë të barabartë. Sepse njerëzit kanë natyra të ndryshme. Mendjet janë gjithashtu mendje të ndryshme. Për këtë arsye, nuk është e drejtë të barazohen nevojat. Por, nuk është njësoj dhe e barabartë që të gjithë të kërkojnë më shumë seç duhet, të kursejnë, ta bëjnë stoli dhe mjet statusi.

Pse e kemi braktisur jetën e thjeshtë që i bën njerëzit të qetë dhe nuk i sforcon kufijtë e fuqisë së tyre në fitim dhe shpenzim? Përveç rritjes së sendeve dhe mallrave të përpunuara në këtë botë, jemi të detyruar të bëjmë jetën që na është imponuar natyrisht nëpërmjet reklamimit dhe marketingut. Megjithatë, ka edhe shkaqe psikologjike. Njëri nga shkaqet është narcisizmi në nivel personal.

Narcisizmi përkufizohet si këmbëngulje, arrogancë, kërkim i vazhdueshëm për epërsi në marrëdhëniet dypalëshe dhe egocentrizëm në të gjitha çështjet. Logjika: «Unë meritoj më të mirën nga gjithçka!», i shtyn njerëzit natyrshëm të shpenzojnë më shumë.

Narcizëm në blerjen, konsumimin ose përdorimin e mallrave, produkteve që japin status dhe prestigj, makina të shtrenjta, shtëpi të mëdha dhe të bukura, ose çdo gjë që shfaq fuqi, status dhe sofistikim. Vitet e fundit shtimi i shpenzimeve dhe kurioziteti ynë i pafund për të grumbulluar mallra është kthyer në sëmundje. Ideja: «Jetoje jetën në mënyrën më të mirë të mundshme dhe shpërbleje veten!», lindi një lloj «narcisizmi kulturor». Nga ana tjetër, sloganet reklamuese promovojnë paturpësisht vendosmërinë materialiste sikur të ishte një virtyt.

Njerëzit që kanë ndikim në shoqëri u ofrojnë të ashtuquajturat stilet e tyre të jetesës rrezatuese atyre që i ndjekin, ose ua fusin me lakmi në sytë e tyre. Ata nxjerrin në pah pasuritë e tyre, duke tunduar materializmin me sharmin, karizmën dhe ndikimin e tyre.

Ekonomisti dhe sociologu amerikan Thorstein Veblen flet rreth konceptit «konsum me qëllim rënien në sy» në teorinë e klasës së papunë (1899). Vebleni argumenton se sjellja njerëzore në kapitalizëm përcaktohet kryesisht nga lufta për vlerësim shoqëror, status dhe pushtet. Kjo ndodh kryesisht në aktivitetet e shpenzimeve dhe të kohës së lirë. Konsumi me qëllim rënien në sy i referohet blerjes, grumbullimit dhe shpenzimit të produkteve dhe artikujve që realisht nuk i nevojiten njeriut, për të shfaqur pasurinë ekonomike dhe materiale para anëtarëve të tjerë të shoqërisë.

«Emulimi material» është një koncept tjetër që shpiku Vebleni. Ky koncept shpreh njerëzit nga grupet e klasave më të ulëta shoqërore të cilët imitojnë në mënyrë të vetëdijshme apo të pavetëdijshme zakonet e shpenzimit dhe konsumit të atyre që janë më lart se ata në aspektin social. Personat në fjalë janë në përpjekje për të formuar lidhjet e tyre me grupet më të fuqishme shoqërore dhe dominuese në shoqëri. Te të gjitha këto sjellje gjendet ideja e pronësisë.

Njerëzit, pasi t'i plotësojnë drejtpërdrejt nevojat e tyre materiale, blejnë atë që nuk u nevojitet ose më shumë ngaqë ky është një tregues i të qenët pranë identitetit dhe stilit të jetesës së një grupi të caktuar shoqëror.

Para së gjithash, zgjidhja është të jesh një fitues i ndërgjegjshëm, një person që blen, kursen, ndan dhe shpenzon. Thelbësore është që me vetëdije të përfitojmë nga mirësitë që na ofrohen, të qëndrojmë larg luksit dhe konsumit për shtirje dhe të adoptojmë vetëm sjellje konsumuese të bazuara në nevojat tona.

Të bëhesh mbeturinë? Apo të mbetesh njeri?

— Halit Serhan Erxhivelek —

Sot, njerëzimi ka ardhur në një udhëkryq në errë-sirën e injorancës moderne. Ata (njerëzit) ose do të vazhdojnë jetën e tyre si mjete të thjeshta në duart e sistemeve supersticioze të shkëputura nga shpallja hyjnore dhe do të presin që të flaken tutje pas përfundimit të misionit të tyre, ose do të bëhen krijesa të nderuara duke dëgjuar thirrjen hyjnore dhe duke hyrë në rrugën e adhurimit ndaj Zotit (xh.xh.).

Kompania më e madhe e mbledhjes së të dhënave në SHBA, e cila ka të dhënat e 300 milionë njerëzve, i ka klasifikuar këta persona në më shumë se 70 kategori sipas fuqisë së tyre ekonomike, ata me fuqinë blerëse më të ulët janë emërtuar “mbeturina” dhe ata me fuqinë blerëse më të lartë janë emërtuar «yje». Mendoni për një sistem që nëse mund të shpenzoni ju konsideron «yll», por nëse nuk keni fuqi ekonomike për të shpenzuar, ju konsideron “mbeturinë”. Kjo është pika e fundit e humanizmit, i cili nisi me parulla të praruara si “Njeriu është masa e të gjitha gjërave”, “Vlera bazë është njeriu”.

Iluminizmi evropian, të cilin mund ta përshkruajmë si ndërprerje e lidhjeve të njeriut me Zotin, gjoja e vendosi njeriun në qendër të gjithçkaje. Ndërkohë, kjo shkëputje ishte në kundërshtim me natyrshmërinë e njeriut, sepse njeriu është krijuar me një natyrshmëri që mund të fitojë një pozitë duke u lidhur me Allahun, qendrën e vetme në univers. Për këtë arsye, njeriu ka filluar të ketë nevojë për një konstante të re. Me kolonializmin dhe Revolucionin Industrial që u zhvillua si rezultat i zbulimeve gjeografike, akumulimi i kapitalit në Evropë i ofroi një konstante të re njeriut perëndimor, lidhjet e të cilit ishin shkëputur me Allahun: pasurinë dhe kapitalin.

Sistemi liberal-kapitalist, i cili e mat njeriun me sasinë e kapitalit që ka, i ka bërë të egër të pasurit që kanë pushtet duke thënë “le ta bëjnë, le të kalojnë”, duke u bazuar vetëm te nefsi emare i njeriut. Sikundër kësaj, i ka injoruar ata që nuk kanë pushtet, domethënë i ka konsideruar mbeturina». Kjo qasje e egër natyrshëm shkaktoi një reagim të madh. Në shekullin e 19-të klasa punëtore në zhvillim veprroi si bartëse standarde e këtij reagimi. Socializëm-komunizmi, i cili mishëroi një version të sistemuar të këtij reagimi si një lëvizje individualizmi, parashtrroi një sistem të ri vlerash duke vënë në pah punën njerëzore kundër borgjezisë që zotëronte kapitalin. “Puna” e pozicionuar kundër kapitalit dhe pasurisë u pranua si vlera e re e njerëzimit. Megjithatë, socializmi dhe kapitalizmi që duket si dy sisteme të ndryshme apo edhe të kundërta, janë në fakt dy konkurrentë që vrapojnë në të njëjtën korsi dhe asgjë më tepër.

Ndërsa kapitalizmi pranoi kapitalin si vlerën që i bën njerëzit njerëzorë, socializmi theksoi punën. Të dy sistemet nuk mundën t’i vlerësonin qeniet njerëzore si qenie njerëzore, sepse botëkuptimi laik-jofetar që përbën bazën e të dy sistemeve ishte i paaftë për t’i takuar njerëzit me vullnetin hyjnor. Ky rreth vicioz që u ngushtua, e bëri njeriun çnje-



rëzor duke e shkëputur nga Zoti (xh.xh.), i Cili i jep vlerën më të madhe njeriut. Mendja laike e konsideronte njeriun, më të nderuarin nga të gjitha krijesat, me potencialin për t'u bërë superior ndaj engjëjve, si një krijesë që evoluoi nga majmuni. Sipas këtij botëkuptimi, njeriu, i cili ontologjikisht nuk është aspak i ndryshëm nga majmuni, mund të fitonte vlerë dhe kuptim vetëm me kapital ose punë. Sipas klasifikimit të mësipërm, i cili nxjerr në pah gjithë perversionin e sistemit kapitalist në pikën ku ka arritur ky degradim, Ebu Xhehli i cili ishte një nga më të pasurit e Mekës, është një «yll», ndërsa i varfëri Bilal el-Habeshiu ose Ammari, radijall-llahu anh, nuk kanë asnjë vlerë, Zot na fal.

Ndërkohë, Allahu e ka zgjedhur njeriun si më-këmbës (shik. Bekare, 30) dhe e ka krijuar atë në formën më të bukur. (Shik. Tin, 4.) Atë e ka bërë krijesën më të nderuar duke ia mësuar emrat e Tij dhe emrat e gjërave. (Shik. Bekare, 31.) Zoti i botëve e ka indeksuar këtë pozitë të nderuar jo te ndonjë vlerë e kësaj bote, por vetëm te zemra e pastër (Shik. Shuara, 88-89) dhe te devotshmëria (shik. Huxhurat, 13). Shembulli monumental i moralit të Allahut të mishëruar në qeniet njerëzore dhe krenaria e njerëzimit, Resulullahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: *“Allahu nuk shikon fizionomitë dhe pasurinë tuaj, por Ai i jep rëndësi zemrave dhe veprave tuaja.”* (Muslim, Birr, 34.)

Hz. Pejgamberi duke u shprehur kështu, i shkatërroi të gjitha kriteret e respektit ndaj pozitës në këtë botë si idhujt brenda Qabesë. Kjo përmbysje e madhe u bë me një metodë të madhe profetike. I Dërguari i Allahut (a.s.), pasi pyeti opinionin e shoqërisë për një besimtar të varfër, por të devotshëm dhe pasi mori vlerësimin se ky një person ishte i pavlerë dhe i parëndësishëm, i zeroi të gjitha kriteret përveç devotshmërisë duke u shprehur: «Ky (i varfëri i devotshëm) është më i mirë sesa bota e mbushur me njerëz si tjetri (gjynahqar, i pasur dhe arrogant).» (Buhari, Nikah, 16.)

Moderniteti, i cili e nisi rrugën duke thënë «njeriu, patjetër njeriu, njeriu është masa e gjithçkaje, e vetmja vlerë është njeriu», e ka humbur «njeriun» në pikën ku ka arritur. Sipas tij, një njeri që nuk prodhon informacion dhe nuk kontribuon në akumulimin e kapitalit të sistemit kapitalist si konsumator është thjeshtë “mbeturinë”. Fundi i mbeturinave është asgjësimi. Në shprehjen e kësaj të vërtete të tmerrshme, zëvendësguvernatori amerikan i Teksasit Dan Patrick, gjatë epidemisë së Covid-it, deklaroi se nuk kishte kuptim të ndalohej ekonomia duke mbajtur në jetë të moshuarit mbi 70 vjeç, të cilët

Ai që jeton në përputhje me Sheriatin e Lartë të të Dërguarit të Allahut (a.s.), në këtë botë do të ketë paqe dhe dinjitet, kurse në botën tjetër do të hyjë në xhenetin Firdeus. Ndërsa ai që ia kthen shpinën sheriatit, do të bjerë në turpin e të qenët i pavlerë si mbeturinat në këtë botë, kurse në botën tjetër do të hidhet në xhehenem.



sipas sistemit kapitalist konsiderohen “mbeturina”. Andaj mbrojtja mendimin që ata të hidheshin në mbeturina.

Sot, njerëzimi ka ardhur në një udhëkryq në errësirën e injorancës moderne. Ata (njerëzit) ose do të vazhdojnë jetën e tyre si mjete të thjeshta në duart e sistemeve supersticioze të shkëputura nga shpallja hyjnore dhe do të presin që të flaken tutje pas përfundimit të misionit të tyre, ose do të bëhen krijesa të nderuara duke dëgjuar thirrjen hyjnore dhe duke hyrë në rrugën e adhurimit ndaj Zotit (xh.xh.).

Hz. Mevlana ajetin: *“Për ata që i frikësohen pozitës së Zotit të tyre ka dy xhenete.”* (Rrahman, 46), e interpreton në formën: “Njëri prej xheneteve është xheneti në botën e përtejme, kurse xheneti tjetër është xheneti i paqes në këtë botë.» Ai që jeton në përputhje me Sheriatin e Lartë të të Dërguarit të Allahut (a.s.), në këtë botë do të ketë paqe dhe dinjitet, kurse në botën tjetër do të hyjë në xhenetin Firdeus. Ndërsa ai që ia kthen shpinën sheriatit, do të bjerë në turpin e të qenët i pavlerë si mbeturinat në këtë botë, kurse në botën tjetër do të hidhet në xhehenem.

Ilaçet e zemrës janë pesë



Prof. Dr. Vahit Goktash

DËSHIRUAM TË NDAJMË ME JU, LEXUESIT TANË TË NDERUAR, LETRËN QË MAHMUD SAMI EFENDI (V. 1984) I DËRGOI ME DORËSHKRIM TË TIJ HALIL FEVZI IPEK EFENDIUT (V. 2017), NDIHMËS MYFTIUT TË JOZGATIT. SHPREHIM MIRËNJOHJEN TONË PËR Z. S. BURHANETTIN KAPUSUZOGLU, I CILI E RUAJTI KËTË LETËR DHE TREGOI BUJARINË E TIJ PËR TA NDARË ME NE.

Dikur kishte letër. Kurse tashmë nuk ka shumë njerëz që shkruajnë letra. Me rritjen e mundësive të komunikimit, është bërë më e lehtë për të shkruar dhe marrë lajme. Letra, e cila ishte mjete më i rëndësishëm

i komunikimit në të kaluarën, tashmë është diçka që ata nën një grupmoshe të caktuar nuk e kanë parë kurrë. Tashmë as letra nuk shkruhen, as laps nuk përdoret. Për fat të keq, kompjuterat dhe pajisjet me prekje e kanë reduktuar vendin e lapsit në jetën tonë.

Letra në të njëjtën kohë ishte edhe një mjet komunikimi. Dijetarët kanë udhëzuar njerëzit me letrat që i shkruanin. Në historinë tonë janë shkruar vepra të llojit mektubat (letrat).

Disa njerëz të lartë i vlerësojnë letrat dhe i mbajnë kartat e urimeve. Andaj me rastin e 12 shkurtit, përvjetorit të vdekjes dhe kalimit në botën tjetër të Mahmud Sami Efendiut (v. 1984), dëshirojmë të ndajmë me ju, lexuesit tanë të nderuar, letrën që ai ia dërgoi me dorëshkrim të tij Halil Fevzi Ipek Efendiut (v. 2017), ndihmës myftiut të Jozgatit. Gjithashtu dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë për z. S. Burhanettin Kapusuzoglu, i cili e ruajti këtë letër dhe tregoi bujarinë e tij për ta ndarë me ne.

Me këtë rast kërkojmë mëshirën e Allahut për Mahmud Sami Efendiun, Halil Fevzi Ipek Efendiun dhe për të gjithë të vdekurit tonë. I lutemi Allahut që t'i mëshirojë të parët tanë dhe t'i bëjë prej banorëve të xhenetit!





بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Për Halil Ipek Efendiun

Es-selamu alejkum,

Jam i kënaqur që kam marrë përshëndetjet tuaja dhe letrën tuaj që përmban urimet për tre muajt e shenjtë dhe netët e bekuara.

Allahu i Madhëruar e bekoftë muajin e Ramazanit për të gjithë besimtarët! Amin! Për të shpëtuar nga shkujdesja dhe për të gjetur paqen, siç thuhet në komentin e Ruhul-Bejanit (në vëllimin 1, fq 581), shërimi i zemrës gjendet në pesë gjëra:

دَوَاءُ الْقَلْبِ خَمْسَةٌ: قِرَاءَةُ الْقُرْآنِ بِالتَّوَدُّعِ ، وَخَلَاءُ الْبَطْنِ ، وَقِيَامُ اللَّيْلِ ،
والتَّضَرُّعُ عِنْدَ السَّحَرِ ، وَمُجَالَسَةُ الصَّالِحِينَ ،
المُصْلِحُ فِي الْحَقِيقَةِ هُوَ اللَّهُ وَلَكِنْ أَشَدُّ الْأَشْيَاءِ تَأْتِيرًا هُوَ الذِّكْرُ قَالَ اللَّهُ تَعَالَى: أَلَا
بِذِكْرِ اللَّهِ تَطْمَئِنُّ الْقُلُوبُ

[Ilaçet e zemrës janë pesë:

Të lexosh Kuran duke medituar, të mos e teprosh me ushqim, të falesh natën, t'i përgjërohesh Allahut në seher (koha pak para agimit) dhe të qëndrosh me të devotshmit. Vërtet, Allahu është ai që përmirëson. Allahu Teala ka thënë: "Me të vërtetë zemrat qetësohen vetëm me dhikrin e Allahut."]

Padyshim, meqë Allahu është Ai që përmirëson, zemra duhet të pastrohet me uri dhe asketizëm, në mënyrë që zemra të dëliret nga paqartësia ndërkohë që lutjet dhe përgjërimet vazhdojnë në seher me kijamu'l-lejl (namaz nate). Kështu, ne duhet të vazhdojmë të bëjmë dhikër pasi mirësia e tij është e madhe siç shprehet në ajetin fisnik: "Ela bi-dhikril-lahi tatmeinnu'l-kulub / me të vërtetë zemrat qetësohen vetëm me përmendjen e Allahut.", sipas aftësisë dhe prirjes së zemrës - dhe të lexojmë Kuran duke medituar kuptimin e tij, i cili është një nga ushqimet shpirtërore të zemrës. Gjithashtu duhet të përfitojmë nga ajeti fisnik: "Ve kunu ma'a's-sadikin / qëndroni me të sinqertët."

[Siç thuhet në ajetin fisnik: "Largohu nga ata që nuk duan asgjë tjetër përveç jetës së kësaj bote dhe ia kthejnë shpinën përkujtimit tonë.", pa dyshim është e dobishme të mos qëndrosh me ata, zemrat e të cilëve janë të shkujdesura, përveç nëse ka ndonjë nevojë të jashtëzakonshme. Allahu i Madhëruar na dhëntë suksese të gjithëve! Amin!

26 Shaban 1382
Ramazanoglu Sami

Suneti i vlerësimit të njerëzve

— Ajdin Bashar —

Besimtare dhe besimtarët e devotshëm, të cilët e kanë arritur sekretin «hyr në mesin e robërve të Mi», gjithmonë u janë drejtuar robërve të Allahut dhe u janë bashkuar atyre duke u përzier me ta. Në mënyrë që besimtarët të bashkohen dhe të ushqejnë dashuri për njëri-tjetrin, është e nevojshme që ata të thonë fjalë të bukura dhe komplimente.

Qëndrimi që Islami dëshiron nga ne në marrëdhëniet ndërnyerëzore është që njeriu të veprojë duke e ndërjet të vërtetën se është krijesa më e nderuar. Në shoqërinë islame, më i vlefshmi nga njerëzit është më i devotshmi. Është një kërkesë e devotshmërisë që t'i vlerësosh njerëzit, t'u qasësh atyre me dhembshuri, të interesohesh me ta pavarësisht nga statusi i tyre në shoqëri dhe të flasësh me ta. Shfaqja e një fytyre të buzëqeshur ndaj njerëzve me të cilët flisni, komplimentimi i tyre dhe përpjekja për të fituar zemrat e tyre janë gjithashtu sunete që lidhen me unitetin dhe bashkimin. Sidomos njerëzit e devotshëm i zbatojnë shumë këto sunete.

Kur shikojmë jetën e të Dërguarit të Allahut (a.s.), shohim se ai qëndronte larg sjelljeve që do t'i bënin njerëzit të ndjenin se nuk vlerësoheshin prej tij. Në

këtë kuptim, ai na ndaloi t'u bëjmë të tjerëve atë që nuk duam të na e bëjnë neve dhe e konsideroi si shenjë të përsosmërisë së besimit që të dëshirojmë për vëllain tonë atë që duam për veten. Ai preoku-

pohej me njerëzit në çdo periudhë të jetës së tij dhe i vlerësonte ata. Kështu qëndronte bashkë me ta aq sa, nëse vinte dikush i huaj, bëhej e detyrueshme pyetja: «Cili nga ju është i pari i këtij populli?»

Gjatë gjithë jetës së Profetit (a.s.), ndeshemi me manifestime madhështore të dashurisë dhe interesimit të tij ndaj njeriut. Në suren Abese, ndoshta si një ngjarje e tillë për t'i dhënë një mesazh njerëzimit, Allahu e di më mirë, është përmendur kthimi i shpinës ndaj një të verbri.

Zoti na faltë, Profeti (a.s.), nuk bëri një gabim me vetëdije apo dëshirë. Në tefsire thuhet se kur Pejgamberi (a.s.), e pa atë person, ia fitoi zemrën duke i thënë: «Përhëndetje personit për të cilin Zoti im më qortoi!» Në këtë ajet, njerëzve u kujtohet se nëse ia kthejnë shpinën vëllait, edhe nëse janë pejgamberë, do të jenë subjekt i paralajmërimit të Allahut.

Meqë i Dërguari i Allahut (a.s.), e kuptoi thellë se të gjithë njerëzit janë robër të Allahut, pothuajse të gjithë i konsideronte bashkëbisedues, nga gjyshja e vjetër e deri te një fëmijë trevjeçar. As nuk përçmoi ndokënd, as nuk e konsideroi dikë të padenjë. Ai i dha çdo njeriu vlerën që meritonte dhe ka bërë gjithmonë atë që ishte e nevojshme për këtë qëndrim. Shkuarja për ngushëllime te një fëmijë që i kishte ngordhur zogu, interesimi i tij për ata që nuk shkonin në xhami, të vizituarit e të sëmurëve dhe të moshuarve, të përgjigjurit ndaj çdo pyetjeje në mënyrë më të mirë të mundshme, fakti që plakës së moshuar e cila dëshironte ta takonte i tha se mund të shkonte ta takonte në çdo vend në Medinë ku ajo donte dhe shembuj të tjerë që nuk mund t'i japim këtu (ngaqë janë shumë), janë tregues të vlerës që ai u jepte njerëzve.

Ibn Hazmi, një nga dijetarët andaluzianë, thotë siç vijon në lidhje me këtë aspekt të tij: «Profeti Muhamed, i cili u dërgua si shembull për njerëzit duke u pajisur me të gjitha llojet e cilësive të përsosura

dhe duke u pastruar nga të gjitha llojet e cilësive të mangëta, shkonte deri në vendet më të largëta të Medinës, edhe pse koka e tij ishte pa çallmë dhe pa mbulesë, këmbët i kishte pa këpucë dhe pa çorape, për t'u interesuar me të sëmurët bashkë me shokët e tij." (Ibn Hazm, Trajtimi i nefseve, Përktheu: Salahaddin Kip, fq. 52.)

Fjalët e mëposhtme të Dirar ibn Damre, të cilat përshkruajnë Hazreti Aliun, radijall-llahu anih, janë gjithashtu shumë domethënëse: "Ai ishte si njëri prej nesh. Kur shkonim tek ai, na afrohej. Kur e pyesnim për diçka, ai na përgjigjej. Kur e ftonim, i përgjigjej ftesës. Kur e pyesnim për ndonjë lajm, na informonte. Pasha Allahun, atë gjithmonë e ndjenim pranë nesh." (Shik. Seffarini, Shemsuddin Ebu'l-avn, Muhammed b. Ahmed b. Salim, Gizau'l-Elbab fi Sherhi Manzumeti'l- Adab, II, 555.)

Siç kuptohet nga këto fjalë, edhe Hazreti Aliu ishte nga ata që e zbatonin sunetin e interesimit me njerëzit të Profetit (a.s.), në mënyrën më të mirë. Ashtu si Profeti, edhe ai bashkohej me njerëzit, merrej me ta dhe u përgjigjej kërkesave të tyre. Mirëpo, në ditët e sotme, siç kemi harruar sunetin e pranimit të ftesës, siç e konsiderojmë barrë sunetin e pritjes së mysafirëve, jemi distancuar edhe nga ky sunet i bukur i Krenarisë së Gjithësisë, të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Besimtarët dhe besimtarët e devotshëm, të cilët e kanë arritur sekretin «hyr në mesin e robërve të Mi», gjithmonë u janë drejtuar robërve të Allahut dhe u janë bashkuar atyre duke u përzier me ta. Në mënyrë që besimtarët të bashkohen dhe të ushqejnë dashuri për njëri-tjetrin, është e nevojshme që ata të thonë fjalë të bukura dhe komplimente. Në një hadith fisnik i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë se besimtar është ai që bën miqësi me njerëzit dhe me të cilin bëhet miqësi. (Shik. Hakim, el-Mustedrek, 1/53; Bezzar, Musned, 15/349; Taberani, el-Evsat, 6/58; Bejhaki, Shuabu'l-Iman, 10/441.) Sipas këtij hadithi, një prej qëndrimeve që nuk i përshtatet myslimanit është mospërziera e tij me njerëzit duke pasur një gjendje të zymtë dhe të ashpër. Përballja me sjellje të ashpra, nënvlerësimi, përcmimi dhe rënia në pozitën e një personi që askush nuk do t'i përgjigjet, janë situata që nuk i pëlqejnë asnjë njeriu. Për shkak të kësaj sjelljeje të gabuar, shumë miqësi marrin fund, shumë njerëz fshihen nga fletorja dhe bien nga sytë e zemrat.

I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, i ka paralajmëruar udhëheqësit që nuk merren me nevojtarët dhe nuk kujdesen për ta siç vijon: "Nëse një kalif ose guvernator ua mbyll derën nevojtarëve e të varfërve dhe i pengon ata për të arritur te ai, edhe Allahu Teala i mbyll dyert e qiellit që të mos i arrijnë kërkesat dhe lutjet e tij." (Ahmed ibn Hanbel, Musned, IV, 231, nr. 18196; Tirmidhi, Ahkam 6, nr. 1332) Për shkak të kërcënimit serioz në këtë hadith, udhëheqësit e drejtë nuk i mbyllin dyert e tyre për popullin dhe i mbajnë gjithmonë të hapura.

Siç dihet, njerëzit u drejtohen sulltanëve të botës për nevojat e tyre materiale dhe shkojnë te sulltanët e zemrës për nevojat e tyre shpirtërore. Sulltanët e zemrës gjithashtu nuk i largojnë njerëzit që shkojnë tek ata për nevojat e tyre shpirtërore dhe kujdesen për njerëzit në kuadrin e traditave dhe mundësive të tyre, qoftë përmes njerëzve që caktojnë ose me metoda të tjera. Sot, ndërsa njerëzit nuk kanë kohë të kujdesen për fëmijët në shtëpitë e tyre, njerëz të panumërt kanë qenë mysafirë te ata. Në fakt, zemrat e miqve të Allahut janë aq të gjera sa të përfshijnë jo vetëm ata që shkojnë për t'i vizituar, por gjithë njerëzimin.

Jeta e miqve të Allahut është plot me shembuj të jashtëzakonshëm të vlerësimit të qenieve njerëzore. Një nga më të folurat për jetën e të ndjerit Mahmud Sami Ramazanoglu (k.s.), ka të bëjë me rëndësinë që ai i jepte vizitës së ndërsjellë. Si domosdoshmëri e besnikërisë dhe bujarisë së tij, ai i vizitonte të afërmit, vëllezërit dhe veçanërisht hoxhallarët e prirjeve të ndryshme dhe kështu arriti t'i fitonte zemrat e tyre. Madje thuhet se Hz. Sami Efendiu nuk prekej nga ata që nuk ia kthenin vizitën, por i vizitonte sërish në një moment tjetër.

I nderuari Abdullah Serti e shpjegon ndjeshmërinë e të ndjerit Musa Topbashit për kujdesin ndaj njerëzve si më poshtë në një intervistë me të: "Kish-te nevojë për batanije natën në Medine, sepse ka shumë njerëz që flenë në rrugë në Medine. Për këtë arsye, hoxha ynë i ndjerë tha një ditë: 'Shikoni, natën është pak ftohtë. Jashtë ka njerëz që flenë, hidhuni një sy!' Dyqind batanije u shpërndanë në një natë. Sigurisht, në atë kohë, ne thamë: 'Pse nuk e pamë këtë?' Në të vërtetë, ta shohësh atë nevojë është pothuajse një cilësi shumë e rëndësishme e atyre miqve të Allahut."



Kushti më i rëndësishëm i lutjes është kafshata hallall

— M. Sami Ramazanollu —

ÇFARË SYNOHET NGA LUTJA?

Një njeri që lutet, duke e ditur se është në nevojë dhe i dobët për ta arritur atë që dëshiron, kërkon nga Allahu atë që i nevojitet. Edhe pse disa njerëz janë pajtuar me kadanë (caktimin) dhe fuqinë e Allahut të Madhëruar dhe kanë preferuar të heshtin më shumë sesa të luten, shumica e tyre e dinë se të gjitha punët e kësaj bote dhe të botës tjetër janë të lidhura me shkaqet. Gjithashtu ata e dinë se edhe lutja e pranuar është një nga këto shkaqe. Kështu që lënien e lutjes e kanë ngjasuar me një vepër të paarsyeshme dhe të paligjshme, si mosngrënia me qëllim për të treguar nënshtrim ndaj caktimit të Zotit, mosmarrja e barnave kur të sëmuresh dhe mospërdorimi i armëve gjatë luftimeve. Në veçanti, lutja është shfaqje e nevojës dhe strehim tek Allahu i Madhëruar. Meqë përgjërimi ndaj Zotit është në pozitën e një adhurimi më vete, lutja me gjuhë dhe pëlqimi e nënshtrimi ndaj caktimit dhe kaderit të Allahut me gjithë zemër janë më përparësorë dhe më të preferuar. Ndërkohë, kushti më i rëndësishëm i lutjes është kafshata hallall. Në një hadith fisnik deklarohet se nëntë të dhjetat e adhurimit dhe bindjes përbëhen nga ngrënia e kafshatës hallall.

Kohët kur pranohen lutjet janë një e treta e fundit e natës dhe seheri (koha pak para agimit) për çdo ditë. Ka hadithe të sakta në lidhje me mirësitë e seherit. Po kështu, dita e xhuma është një ditë e nderuar për lutje. Bazuar në këto që thamë, ditën e xhuma (e premte) është e nevojshme që t'i shtojmë lutjet në krahasim me ditët e tjera. Po kështu, në kohë të nderuara si Nata e Kadrit, ditët para bajrameve, muaji i Ramazanit dhe netët e tjera të mira, është e nevojshme që ne të vazhdojmë t'i lutemi Allahut ndërkohë që zemra është e pastër, e mëshirshme dhe e gatshme për t'u lutur. Gjithashtu duhet të lutemi veçanërisht në kohën kur mëshira hyjnore zbret në netët e bekuara dhe në namazet që falen me xhemat.

MALLKIMI

Kushti më i rëndësishëm i lutjes, siç e thamë edhe më parë, është kafshata hallall.

“Kush ndërmjetëson për një çështje të mirë, do të ketë pjesë në shpërblimin e saj, kurse kush ndërmjetëson për një çështje të keqe, do të ketë pjesë në ndëshkimin e saj. Allahu është i Gjithëpushtetshëm.” (en-Nisa, 85)

Ajo që nënkuptohet me ndërmjetësim në këtë ajet është: I Dërguari i Allahut (a.s.), siç i inkurajonte besimtarët për në luftë, gjë që është urdhërim për të mirë, edhe i toleronte disa besimtarë që qanin ngaqë dëshironin të shkonin në luftë, por nuk shkonin dot ngaqë nuk kishin përgatitjet e duhura. Mundësia e ndërmjetësimit për ta ishte për shkak se ata ishin të butë dhe kishin dëshirë të shkonin në luftë. Cilido qoftë kuptimi që synohet, aty përfshihet urdhri për të mirën dhe ndërmjetësimin e tillë.

Sipas tefsirit të Nimetullahut, ajo që nënkuptohet me ndërmjetësimin e mirë është ndërmjetësimi që bëhet për hir të kënaqësisë hyjnore duke kërkuar mirësinë, duke u larguar nga e keqja dhe duke mos synuar ndonjë përfitim për nefsën krahas respektimit të ligjit të Allahut dhe të drejtave të robërve (njerëzve).

Po kështu, është interpretuar se lutjet që bëjnë besimtarët për njëri-tjetrit me mirësi, përpjekja për të mirën e një njeriu në mungesë të tij dhe angazhimi për largimin e ndonjë problemi të besimtarit do të thotë ndërmjetësim i mirë.

Sipas Tefsirit Hazin, me ndërmjetësimin e keq synohen gjëra si përpjekja për t'i bërë ligësi dikujt, ose bartja e fjalëve për të ngjallur armiqësi dhe trazira mes njerëzve, ose mallkimi ndaj besimtarëve. Ja pra, në këtë ajet fisnik gjendet argumenti se njeriu që ndërmjetëson për keq do të ketë pjesë nga e keqja e tij në botën tjetër. Madje, ai do të marrë dënimin për ligësinë dhe dëmin e ndërmjetësimit për keq dhe mallkimit të tij edhe në këtë botë.

Profeti (a.s.) dhe fëmijët

— Sadik Dana —

I Dërguari i Allahut (a.s.), i donte shumë fëmijët. Enes ibn Maliku, radijall-llahu anh, thotë:

«I Dërguari i Allahut ishte më i mëshirshmi i njerëzve ndaj fëmijëve.» Kurse Abdullah ibn Omeri, radijall-llahu anh, transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s.), thoshte për nipërit e tij, Hasanin dhe Hysejnin:

«Dy borzilokët e mi në këtë botë.»

Enes ibn Maliku (r.a.), gjithashtu ka transmetuar se ai (a.s.), i ka nuhatur, i ka përqaftuar dhe është lutur për ta. Usame ibn Zejdi (r.a.), ka thënë:

«I Dërguari i Allahut më vendoste mua në njërin gju dhe Hasan ibn Aliun në gjurin tjetër. Pastaj na përqaftonte të dyve njëherësh dhe thoshte:

“O Zot, mëshiroji këta, unë jam shumë i mëshirshëm ndaj tyre.”

Pa dyshim, dashuria dhe dhembshuria e Resulullahut (a.s.), nuk ishte vetëm për nipërit e tij. Ai shprehej:

«Nuk është prej nesh ai që nuk shfaq dhembshuri ndaj të vegjëlve tanë.» (Ebu Davud, Edeb 68.)

Pejgamberi (a.s.), e shfaqti dashurinë dhe dhembshurinë e tij ndaj fëmijëve në mënyra të ndryshme dhe në formën më të denjë në çdo rast, pa bërë dallime mes djemve dhe vajzave. Nënata, baballarët dhe të mëdhenjtë gjithmonë i ka ftuar dhe inkurajuar që të jenë të ndjeshëm dhe të kuptueshëm ndaj fëmijëve.

Sipas transmetimeve të bëra nga sahabët e ndryshëm, i Dërguari i Allahut (a.s.), i përqaftonte fëmijët, i puthte, i donte, i hipte në kafshën e tij, i përshëndeste, i gëzonte, shkonte t'i vizitonte kur ata ishin të sëmurë, bënte shaka me ta, i argëtonte, i vinte mbi supe, mbi kurriz dhe nuk i qortonte kurrë.

Jusuf ibn Abdullah ibn Selami, radijall-llahu anh, tregon: «Kur isha fëmijë, i Dërguari i Allahut (a.s.), më vuri emrin Jusuf, më mori në krahë dhe më përkëdheli kokën.»

Abdullah ibn Busri (r.a.), ka transmetuar se i ka shërbyer ushqim të Dërguarit të Allahut, paqja dhe

mëshira e Allahut qofshin mbi të, se pas ushqimit ai është lutur për pjesëtarët e familjes sipas zakonit të tij, se pastaj ia kishte përkëdhelur kokën atij dhe se kishte thënë që ky fëmijë do të jetojë një shekull.

Abdullah ibn Xhaferi, radijall-llahu anh, thotë:

«Ndërsa i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, kthehej nga ekspedita, ne i nxirrim nipat e tij, Hasanin dhe Hysejnin për ta pritur. Të parin që e përshëndeste e vinte përpara në kafshë, ndërsa tjetrin pas shpine dhe kështu i sillte në Medinë.»

Enes ibn Maliku, radijall-llahu anh, transmeton se:

«I Dërguari i Allahut (a.s.), u thoshte: «Es-selamu alejkum ja sibjan - paqja e Zotit qoftë mbi ju, fëmijë!», kurse një fëmijë të cilit i kishte ngordhur zogu që e donte shumë, e pyeti: «O Ebu Umejr, çfarë ka ndodhur me zogun tënd të vogël?» - dhe se kur e pa atë të pikëlluar, e ngushëlloi.»

Ebu Hurejra, radijall-llahu anh, ka thënë:

Kur Akra ibn Habithi e pa të Dërguarin e Allahut (a.s.), duke puthur një nga nipërit e tij, i tha:

«Unë kam dhjetë fëmijë, nuk kam puthur asnjërin prej tyre.» Kurse i Dërguari i Allahut (a.s.), i dha këtë përgjigje:

«Nuk ka mëshirë për ata që nuk tregojnë mëshirë.» Gjithashtu, një njeri nga Medina i tha:

«Unë kam një djalë, ai ka arritur moshën e pubertetit, por nuk e kam puthur qoftë edhe një herë.» Hz. Pejgamberi (a.s.), i tha edhe atij:

«Çfarë të bëj unë nëse Allahu ta ka hequr mëshirën nga zemra? (Cili është mëkati im për këtë?)»

Përveç këtyre, i Dërguari i Allahut (a.s.), i lavdëronte dhe vlerësonte prindërit që kujdeseshin për fëmijët e tyre.



LOKMAN HAKIMI – 1

Lokman Hakimi është bërë i famshëm përmes urtësive të shumtë. Sipas transmetimeve prejar-dhjen e largët e ka prej Ejubit (a.s). Lokman Hakimi ka qenë bashkohës me shumë Pejgamberë. Lokman Hakimi mund të ketë qenë pejgamber ose evlija, shumica e dijetarëve islam janë të mendimit se ai nuk ka qenë një pejgamber por një njeri i mirë. Në lidhje me urtësinë e tij Kurani thotë:

Ne i dhamë Lukmanit urtësinë (duke i thënë):
“Falënderoje Allahun! Kush është falënderues,
e bën për të mirën e vet dhe, kush mohon, ta
dijë se vërtet Allahu është i Vetëmjaftueshëm
dhe i Denjë për lavdërim”. (Lukman,12)

Urtësia është aftësia për të kuptuar thelbin e gjërave.

Urtësia është të njohësh paaftësinë e mendjes për të kuptuar dhe njohur disa të vërteta. Ka shumë të vërteta dhe të fshehta të cilat nuk njihen përmes mendjes por përmes urtësisë. Të gjitha shfaqjet hyjnore në univers duhet të vlerësohen me syrin e urtësisë.

Nëse nuk do të ishte urtësia shumë të fshehta do të mbetnin të pazbuluara. Pa urtësi nuk do të ishin shumë personalitete shpirtërore.

Lumenjtë e urtësisë rrjedhin vetëm në zemrat që janë pastruar. Besimtari e arrin pastërtinë e





zemës në raport të drejtë me dashurinë dhe bindjen ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij.

Qëllimi përfundimtar i diturisë është thellimi në urtësi. Urtësia është të zgjidhësh enigmat e pafundme që Allahu ka shfaqur në Kuran, Univers dhe tek njeriu. Urtësia është të vetëdijeshohesh për madhësitinë e Allahut që shfaqet në çdo grimcë të vogël.

Mjekësia studion rregullat që Allahu ka vendosur në trupin e njeriut. Botanika studion rregullat që Allah ka vendosur tek bima, kurse urtësia angazhohet totalisht në të gjitha ligjet dhe rregullat e të gjitha shkencave. Dituria merret vetëm me anën e jashtme të objektit të studimit kurse urtësia depërton përtej anës së jashtme. Kjo është e mundur vetëm me dritën që Allahu hedh në zemrën e njerëzve të Tij.

Ai ia jep urtësinë (të kuptuarit e Kuranit) kujt të dojë. Cilatdo që i është dhënë urtësia, vërtet që i është dhënë një mirësi e madhe. Por këtë nuk e kupton tjetërkush, përveç njerëzve të mençur. (Bekare, 269)

Kuptimi i fjalës “urtësi”, është niveli i pjekurisë shpirtërore, e cila fitohet me ngritje shpirtërore pasi janë zotëruar dijet e tjera të natyrës. Pra, aftësia për të vepruar gjithmonë të drejtën, si në fjalë, ashtu edhe në vepra.

“Urtësi”, do të thotë të mund të perceptosh të vërtetën dhe enigmën e materies. Dhe kjo, është e mundur me anë të shfaqjes në zemër të dritës hyjnore. Zemahsheri, si shembull të urtësisë së Lukman Hekimit, na përcjell këtë ndodhi:

Një ditë, Daudi (a.s.), kërkoi nga Lukman Hekimi (a.s.), të priste një dele e t'i sillte dy copa mishi nga vendi më i mirë. Lukman Hekimi (a.s.), e theri delen dhe i çoi Daudit (a.s.), gjuhën dhe zemrën. Pasi kaluan ca ditë, Daudi (a.s.), i kërkoi t'i sillte dy copa nga vendi më i keq. Lukman Hekimi (a.s.), i çoi përsëri gjuhën dhe zemrën. Kur Daudi (a.s.), kërkoi të dinte shkakun, ai iu përgjigj kështu:

“Po të jenë të mira këto të dyja, nuk mund të ketë të tjera më të mira se këto; por, nëse këto të dyja janë të këqija, as të tjerat nuk mund të jenë më të këqija se këto!...” (Zemahsheri, Keshshaf, V, 18.)



“Robi thotë një fjalë e cila i pëlqen Allahut, por nuk i shkon ndërmend se me të do të fitojë pëlqimin e Allahut. Kurse Allahu, për shkak të asaj fjale, mbetet i kënaqur prej tij gjer ditën e kiametit, kur robi do të takohet me të! Gjithashtu, robi thotë një fjalë që duhet ndëshkuar nga Allahu, por nuk mendon se ajo fjalë ka për të bërë që ta godasë ndëshkimi i Allahut. Kurse Allahu, për shkak të asaj fjale, e ndëshkon robin gjer ditën e kiametit, kur robi do të takohet me të!”

(Tirmidhi, Zuhd, 12; Ibni Maxhe, Fitn, 12)

Zemra dhe pasqyra e saj gjuha janë dy organet që e çojnë njeriun në fitore ose humbje. Kushti për të qenë Imani i vlefshëm është shqiptimi me gojë dhe pranimi me zemër.

Profeti (a.s) thotë:

“...Në trup ndodhet një copë mishi, e cila nëse është e mirë, i gjithë trupi është mirë. Por, nëse ajo është e prishur, i gjithë trupi priset. Bëni kujdes! Ajo (copë mishi) është zemra!” (Buhari, Iman, 39)

Njërit prej sahabëve të tij më të zgjedhur, Muadhiti (r.a.), i Dërguari i Allahut (a.s.), i tha disa herë me radhë: “Edhe kjo nuk mjafton!”, duke e këshilluar atë që të bënte më shumë. E më në fund i tha:

“A të tregoj për atë që është më e rëndësishme në të gjitha këto?”

“A të tregoj për atë që është më e rëndësishme në të gjitha këto?”

“Po, më trego o i Dërguar i Allahut!”, - tha Muadhi (r.a.). Më pas, Profeti (a.s.), kapi gjuhën dhe tha:



“Ruaj gjuhën!” Muadhi (r.a.), pyeti:

“A do të merremi në llogari edhe për ato që flasim?” Ndërsa i Dërguari i Allahut u përgjigj:

“Allahu të dhëntë mirësi o Muadh! Por ajo që i zvarrit (më së shumti) njerëzit me fytyrë për tokë në Xhehenem, është vetëm ajo që del prej gjuhës!¹

Prandaj duhet të kemi shumë kujdes dhe të përgjegjshëm për atë që themi.

Përsëri në lidhje me këtë Profeti (a.s) thotë:

“Po qe se robi thotë aty për aty një fjalë pa e menduar dhe peshuar mirë, për pasojë, bie në vendin më të largët në mes lindjes dhe perëndimit të xhehennemit!” (Buhari, Rikak, 23)

“Robi thotë një fjalë e cila i pëlqen Allahut, por nuk i shkon ndërmend se me të do të fitojë pëlqimin e Allahut. Kurse Allahu, për shkak të asaj fjale, mbetet i kënaqur prej tij gjer ditën e kiametit, kur robi do të takohet me të! Gjithashtu, robi thotë një fjalë që duhet ndëshkuar nga Allahu, por nuk mendon se ajo fjalë ka për të bërë që ta godasë ndëshkimi i Allahut. Kurse Allahu, për shkak të asaj fjale, e ndëshkon robin gjer ditën e kiametit, kur robi do të takohet me të!” (Tirmidhi, Zuhd, 12; Ibni Maxhe, Fitn, 12)

1. Shih. Tirmidhi, Iman, 8; Ibn-i Maxhe, Fitn, 12.

Pra është shumë e rëndësishme të jetë nën kontroll zemra që është vatra e ndjenjave dhe gjuha që është pasqyra e saj.

Në lidhje me këshilla të tilla të shumta, Lokman Hakimi është bërë i njohur dhe urtësitë e tij kanë mbërritur deri tek ne. Urtësitë e tij përmenden në Kuran, hadithe dhe nëpër shumë libra të tjerë historikë.

Në Kuran bëhen të ditura fjalët e urta të Lukmanit dhe këshillat që i ka dhënë të birit:

“*(Kujtoje) kur Lukmani i tha të birit, duke e këshilluar: «O djali im, mos i shoqëro Allahut asgjë (në adhurim)! Pa dyshim, idhujtaria është një padrejtësi shumë e madhe!»*” (Lukman, 13)

Padrejtësia, është e kundërta e drejtësisë. Ndërsa drejtësi, do të thotë t’i japësh një qenieje vlerën që meriton dhe ta vendosësh atë në vendin që meriton. T’i bësh ortak Allahut, i Cili është Krijuesit i gjithësisë dhe Pronari i vetëm i gjithçkaje, do të thotë të mos ia japësh Atij vlerën që meriton. Për këtë arsye, rezultati i shirkut (ortakërisë) ndaj Allahut, është qëndrimi përjetësisht në xhehenem.

Besimtari duhet t’i besojë Allahut pa asnjë mëdyshje, besimtari duhet të besojë që gjithçka që ekziston është nën sundimin e Allahut. Teuhidi nuk pranon asnjë lloj shirku.

Ka disa njerëz që thonë: “Besojmë në Allahun dhe në Ditën e Gjykimit!”, por në të vërtetë ata nuk janë besimtarë. Ata përpiqen të mashtrojnë në Allahun dhe besimtarët, por në të vërtetë mashtrojnë vetëm vetveten, megjithëse nuk e ndiejnë. (Bekare, 8-9)

Në të vërtetë, Allahu nuk u bën njerëzve asnjë të keqe, por njerëzit i bëjnë keq vetvetes. (Junus,44)

Në një hadith kudsî thuhet:

“Unë jam larg (më i Larti) prej çdo gjëje që më bëhet shirk (më shoqërohet). Kushdo që bën një vepër dhe bashkë me Mua bën ortak dikë tjetër në atë (vepër), unë do ta lë vetëm për vetëm me shirkun e tij.” (Muslim, Zuhd, 46.)

Profeti (a.s) i këshillon kështu sahabët:

“Më shumë, në lidhje me umetin tim, më frikëson shirku. Me fjalën shirk nuk nënkuptoj adhu-

rimin e hënës, të diellit apo adhurimin e idhujve, por kam parasysh çdo vepër që bëhet për çdo qëllim tjetër përveçse për të fituar kënaqësinë e Allahut, dhe egon e fshehtë (dëshira për t'u shfaqur e dukur).” (Ibn Maxhe, Zuhd, 21)

Hipokrizia është një sjellje që nuk mund të përputhet kurrë me besimin. Njeriu që beson, duhet të jetë i sinqertë dhe i drejtë si në marrëdhëniet me Allahun, ashtu edhe në marrëdhëniet me njerëzit. Përndryshe, ai përballlet me rrezikun e ngjasimit me hipokritët. Në Kuranin Fisnik, hipokritët qortohen në mënyrë serioze për shkak se ata i kryejnë vetëm për t'u dukur adhurimet si namazin, zekatin dhe sadakanë. Ato adhurime që nuk kryen me sinqeritet të pastër vetëm për Allahun janë të pavlera.

“Ditën e Kiametit, personi i parë që do të japë llogari, do të jetë dëshmorë (shehidi, martiri). Ai do të sillet para Zotit, i Cili do t'i kujtojë dhuntitë që i ka dhënë. Dëshmorit do t'i kujtohen dhe do t'i pohojë. Atëherë Allahu do ta pyes:

«Mirë, por çfarë bëre në këmbim të këtyre?»

«Luftova në rrugën tënde gjersa rashë dëshmor në rrugën Tënde!» - I përgjigjet personi. Allahu i thotë:

«Po gënjen! Ti luftove që njerëzit të të përme-ndin për hero dhe ashtu ndodhi!»

Pastaj jepet urdhër dhe ai person hidhet me fytyrë në Xhehenem. Pas tij, para Allahut sillet një person që ka marrë dituri, që u ka dhënë mësim të tjerëve dhe ka kënduar Kuran. Allahu i kujton atij dhuntitë që i ka dhënë dhe i dituri i kujton e i pohon ato. Më pas Allahu e pyet:

«Mirë, por çfarë bëre në këmbim të këtyre të mirave?»

«Mësova dituri, ua mësova edhe të tjerëve dhe këndova Kuran për kënaqësinë Tënde!» - I përgjigjet personi. Allahu i thotë:

«Po gënjen! Ti mësove dituri që të thonë për ty se sa i ditur je, dhe këndove Kuran që të thonë se sa bukur këndon. Dhe, të gjitha këto u thanë!»

Edhe për të jepet urdhër, dhe ai hidhet me fytyrë në Xhehenem. Pastaj sillet një person të cilit Allahu i kishte dhënë çdo mundësi materiale dhe pasuri. Allahu ia kujton dhuntitë dhe ai i kujton e i pohon. Më pas Allahu e pyet:

«Mirë, por çfarë bëre në këmbim të këtyre të mirave që të janë dhënë?»

«Nuk u kurseva të jap nga pasuria në të gjitha ato vende që ti i pëlqen, dhe shpenzova vetëm për të fituar kënaqësinë Tënde!» - I përgjigjet personi. Allahu i thotë:

«Po gënjen! Ti i bëre të gjitha këto që të thonë se sa bujar je!». Dhe, kjo u tha!»

Edhe për të jepet urdhër, dhe ai hidhet me fytyrë në Xhehenem.” (Muslim, Imare, 152)


Pra shirku i fshehtë edhe veprat më të vyera i bën të pavlera duke u bërë shkak për të përfunduar në Xhehenem. Prandaj besimtari duhet të jetojë gjithmonë me vetëdijen e ajetit kuranor:

Thuaj: “Unë jam vetëm një vdekatar si ju, që më është shpallur se Zoti juaj është një Zot i Vetëm. Kështu, kush shpreson takimin me Zotin e vet, le të bëjë vepra të mira dhe të mos i shoqërojë askënd në adhurim Zotit të vet!” (Kehf, 110)

Lokmani thotë:

“O djali im! Allahu do ta nxjerrë në shesh edhe veprën që peshon sa kokrra e sinapit që ndodhet në shkëmb, në qiej apo në tokë. Me të vërtetë, Allahu njuh mirë çdo imtësi dhe i di të





gjitha fshehtësitë. O djali im! Kryeje namazin, urdhëroje të mirën, pengoje të keqen dhe bëhu i durueshëm për çfarëdo që të godet! Me të vërtetë, ky është thelbi i patundur i të gjitha punëve!” (Lukman, 16-17)

Në ajete të tjera Kurani thotë:

O Zoti ynë, Ti e di vërtet çfarë fshehim e çfarë shfaqim haptazi. Allahut nuk i fshihet asgjë, as në Tokë, as në qiell. (Ibrahim,38)

Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë, 8. e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë. (Zelzele, 7-8)

Allahu në mënyrë që të veprojmë vetëm punë të mira e ka fshehur se në cilën vepër të mirë është dashuria dhe falja. Ndonjë herë dashuria dhe mëshira e Allahut është në një vepër shumë të madhe, ndonjëherë në një vepër mesatare dhe ndonjëherë është e fshehur në një vepër në dukje shumë e parëndësishme. Prandaj asnjë vepër e vogël nuk është e parëndësishme. Allahu nuk e humb asnjë vepër të mirë e bërë haptas ose fshehurazi. Besimtari duhet të tregojë kujdes të jetë gjithmonë i gatshëm për vepra të mira dhe të bëjë përpjekje të qëndrojnë sa më larg veprave të këqija.

Po ashtu në mënyrë që të mbrohemi nga të gjitha veprat e këqija e ka fshehur se në cilën ndo-

dhet zemërimi i Tij. Nganjëherë zemërimi hyjnor ndodhet në një mëkat të madh, nganjëherë në një mëkat mesatar dhe nganjëherë në një mëkat të vogël. Prandaj Neglizhimi i mëkateve të është një mashtrim i madh.

Profeti (a.s) ka thënë:

“Ruhuni prej gjynaheve që duken të vogla, sepse ato mblidhen tek dikush dhe në fund e shkatërrojnë atë!” (Ahmed, I, 402-403; V, 331)

Një i urtë ka thënë:

Nëse nuk hiqet dorë prej mëkateve të vogla por vazhdohet me kryerjen e tyre ato nuk mbesin më të vogla për shndërrohen të mëdha.

Bilal bin Sa'd ka thënë:

“Mos shih vogëlsinë e gjynahut, por kundër kujt e bën atë gjynah!”

Lokmani thotë:

“ Unë urtësinë e mësova nga të verbrit. Sepse ata nuk hedhin asnjë hap pa e kontrolluar më parë vendin me bastunët e tyre.

Nëse me mëkatet me të cilat përballemi gjatë gjithë jetës nuk bëhet kujdes në këtë botë, në ditën u gjykimit ato janë si një bombë për ne. Çdo veprim dhe sjellje që bëhet pa menduar nëse është haram apo hallall është si një bombë me saat ditën e gjykimit.

Besimtari në çdo punë që bën duhet të shikojë a është e përshtatshme me kriteret hyjnore apo jo. Nëse është e dobishme për këtë botë dhe botën tjetër e vepron në të kundër heq me njëherë dorë prej saj. Besimtari nuk merr asnjë ushqim pa u siguruar nëse është hallall apo haram.

Rrumiu thotë:

“Edhe qeni madje nuk e ha një kockë apo ushqim pa e nuhatur”

Pra vrapimi pas interesit pa bërë asnjë dallim midis haramit, hallallit, të mirë, të keqes, të drejtës dhe të shtrembrës, e çon njeriun në një nivel më të ultë se kafsha.

Përsëri Rrumiu thotë:

“Edhe një verbër e kupton që ka lindur dielli nga nxehtësia”

Pra ai që nuk tregon kujdes dhe ndjeshmëri ndaj kriterëve hyjnore është i verbër shpirtërisht.

Zemra e tij është përfshirë nga një neglizhencë e tillë që e ka bërë atë si të vdekur.

Omer ibn Abdulazizi thotë:

“Haramet janë një zjarr! Atyre u zgjasin dorën vetëm ata që janë (me zemër) të vdekur. Nëse ata që u zgjasin dorën do të ishin të gjallë, do ta ndjenin djegien e atij zjarri.”

Besimtari duhet të eci në këto botë sprovash si në një parcelë të minuar. Duhet të ketë shumë kujdes se ku e hedh hapin. Sepse Allahu kërkon prej nesh të bëjmë një jetë plot devocion.

Ky përshkrim i Omerit (r.a) e tregon shumë bukur natyrën e devocionit.

Një ditë, Omeri (r.a), e pyet Ubej bin Ka'bin (r.a), se “Ç’është devotshmëria?” Ubej (r.a) i tha:

“O Omer! A ke ecur ndonjëherë në një rrugë me gjemba?”

Omeri (r.a) u përgjigj:

“Po, kam ecur.” Atëherë Ubej (r.a), e pyet përsëri:

“Po mirë, çfarë bëre?” Omeri (r.a) u përgjigj kështu:

“Përvësia rrobën time dhe bëra shumë kujdes për t’u ruajtur nga gjambat.” Atëherë Ubej (r.a) thotë:

“Ja pra, kjo është devotshmëria!”

Shfaqja më domethënëse e devotshmërisë është largimi prej shirkut, mosbesimit dhe hipokrizisë siç largohemi prej zjarrit dhe zbatimi me përpikëri i urdhëresave hyjnore.

Lokmani thotë:

O bir! Mos e preokupo zemrën me mendime negative dhe shqetësime të ndryshme! Qëndro larg babëzisë! Kënaqu me caktimin! Ji i kënaqur me atë që të ka dhënë Allahu në mënyrë që të zbukurohet jeta, të mbushet zemra me gëzim dhe të shijosh lumturinë e kësaj jete.”

Allahut thotë në Kuran:

Për sa i përket njeriut, kur Zoti i tij e sprovon atë, duke e ngritur lart dhe duke i dhënë mirësi, ai thotë: “Zoti im më ka nderuar.” Por, kur e sprovon atë, duke ia ngushtuar mjetet e jetesës, ai thotë: “Zoti im më ka poshtëruar”. (Fexhr, 15-16)

Në peshoren hyjnore në ahiret, do të bëhet e qartë se çfarë ka qenë më e mirë për njeriun, mirësitë e pakta apo të shumta. Kjo, sepse mirësia e paktë, ka më pak përgjegjësi, ndërsa mirësitë e shumta kanë më tepër. Në fakt, për njeriun i cili nuk mund t’i kuptojë siç duhet urtësitë dhe të fshehtat e caktimit hyjnor, është më mirë që t’i dorëzohet caktimit të Allahut.

Të pranosh me kënaqësi ngjarjet dhe ndodhitë të që japin gëzim dhe të refuzosh me përbuzje ngjarjet dhe ndodhitë që të shkaktojnë shqetësime dhe dhimbje nuk i përshtatet edukatës së adhurimit. Pa arritur një pjekuri shpirtërore është shumë e vështirë për të shpëtuar prej kësaj. Kur shpirti arrin gradën Radije, njeriu tregon dorëzim të plotë përballë çdo verdikti që ka dhënë Allahu për të. Ai në asnjë mënyrë nuk ankohet për gjendjen e tij. Në lidhje me këtë Allahu thotë në Kuran:

O ti shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty! Bashkohu me robërit e Mi dhe hyr në Xhenetin Tim! (Fexhr, 27-30)

Kushti kryesor i lumturisë është ta vendosësh mendjen nën udhëzimin e shpalljes, ta zbukurosh zemrën me moral të bukur dhe të jesh i kënaqur me caktimin e Allahut. Të tregohet durim dhe të bëhet përpjekje për të gjitha ndodhitë dhe fatkeqësitë me të cilat mund të përballemi në jetë. Gjithmonë duhet të jemi optimistë edhe në situatat e vështira të mendojmë mirësitë e fshehura në të. Të gjitha këto arrihen duke iu mbështetur plotësisht Allahut.

Rrumiu thotë:

“Bota jote e brendshme është si një strehë mysafirësh. Gëzimet e hidhërimet hyjnë e dalin. Mos u mashtro nga gëzimet, e as mos u mërzi nga hidhërimet! Mos u mërzi nëse pikëllimet pengojnë lumturinë tënde! Sepse nëse duron pikëllimet sot, ata janë lajmëtarë të gëzimit dhe lumturisë së të ardhmes”.

Na bëftë Allahu prej atyre që dorëzohen Atij plotësisht dhe që qëndrojnë larg kurtheve të egos dhe shejtanit. I lutemi Allahut të na bëjë prej atyre që janë të kënaqur me caktimin e Tij qoftë mirësi qoftë vështirësi.

Amin...



FETARIZMI I INTEGRUAR ME DASHURI DHE ADHURIM

— Ali Riza Temel —

Ndërsa gjëja kryesore në fetarizëm është dashuria, sinjeriteti dhe emocioni, është adhurimi dhe bindja që i ushqen dhe i mban gjallë këto. Besimi dhe veprat përmenden së bashku në më shumë se pesëdhjetë vende në Kuranin Fisnik. Gjithashtu, është theksuar se vepra duhet të jetë e mirë. Andaj kanë thënë se besimi pa vepra është si pema pa fruta.

Veprat si një grup rregullash e dispijlojnë fetarizmin. Ato sigurojnë që feja të zbatohet sipas rregullave të përcaktuara nga Allahu (xh.xh.), jo sipas kënaqësisë dhe botëkuptimit të secilit, në këtë mënyrë formohet një unitet veprimi dhe qëllimi midis njerëzve fetarë. Ndërsa thelbi është kryesor, guaska që mbron thelbin është gjithashtu e nevojshme. Vezët pa lëvozhgë dhe mjalti pa huall janë të paimagjinueshme. Gjësë që dërgohet me zarf, i duhet një zarf. Por zarfi bosh dhe hualli që nuk mban mjaltë, nuk mbartin ndonjë kuptim të madh më vetë.

Një fetarizëm, kënaqësia, emocioni dhe dashuria e të cilit nuk mund të arrihen, shndërrohet në barrë. Ngaqë hipokritët falnin namaz për të shpëtuar nga detyrimi dhe për t'u dukur, Zoti (xh.xh.), e përshkruan gjendjen e tyre siç vijon: **“Kur ngrihen për namaz, ngrihen me përtesë, shtirën para njerëzve dhe e përmendin pak Allahun.”** (Nisa, 142) Nga ana tjetër, Profeti (a.s.), ka thënë: **“Drita e syrit tim është namazi.”** Kur ai haste në ndonjë problem, menjëherë i drejtohej namazit, merrte forcë nga prania në audiencën e Zotit dhe e vazhdonte de-

tyrën e tij të ftesës me këtë forcë të freskët. Dihet se ai falej natën derisa i ënjtëshin këmbët. Ata që e bënë të fortë atë në luftën e tij ishin ibadetet që i kryente me sinjeritet dhe dashuri. Siç ka thënë profesori ynë i ndjerë, Emin Eshëk, besimi i vetëm pa iu bindur urdhrave dhe ndalesave të fesë dhe pa pasur vepra, nuk ia mundëson robit të zhvillohet në fushën shpirtërore. Bollëku nuk vjen pa lëvizje, pa vrapuar nuk merret rruga. Gara nuk fitohet duke numëruar në vend.

Kjo deklaratë e profesor Eminit është jashtëzakonisht e bukur: Një njeri që qëndron larg adhurimit mbetet si spektator i fesë së tij, edhe nëse e ka zemrën plot besim. Ai bie në gjendjen e vetëm një simpatizanti të një klubi sportiv. Ai njeri nuk ka luajtur me top (bërë ndeshje) as edhe një herë në jetë, por nuk ka munguar asnjëherë në një ndeshje të klubit që simpatizon, pra, gjithmonë e ka ndjekur si spektator. Ja pra, pikërisht si ky, një besimtar pa vepra mbetet si një spektator ndaj detyrave të fesë së tij. Shumë njerëz thonë se zemrat e tyre janë plot besim, por mënyra e jetesës së tyre është e ngjashme me mënyrën e jetesës së njerëzve të pafe. (Kime Kulsun-Rob i kujt je? fq. 50.)

Profesori ynë, Emini rrëfen një anekdotë të tillë që shpreh botëkuptimin e adhurimit dhe dashurisë mes qarqeve sunite dhe bektashiane:

“Një ditë u takuam me dedenë e ndjerë bektashi, Zejnel Dede, dhe biseduam pak. Gjatë bisedës, ai u kthye nga unë dhe më tha: <I nderuar! Feja përbëhet nga adhurimi dhe dashuria. Feja përbëhet nga

këto të dyja. Ata t'uaajt (domethënë Sunitët) flasin për adhurimin, por e kanë braktisur dashurinë. Kurse këta tanët (bektashinjët) flasin për dashurinë, por e kanë braktisur adhurimin. Të dyja janë gabim. Kur dashuria dhe adhurimi shkojnë së bashku, feja bëhet fe. Përndryshe, nuk është asgjë.” Ky njeri ishte një besimtar, i cili shkoi në pelegrinazh (haxh) me një grup prej tridhjetë a dyzet vetash, kishte ndërthurur adhurimin me dashurinë siç e përshkroi dhe kështu e kishte vazhduar jetën. Pasi ta zbatojmë fenë në tërësi, nuk ka rëndësi të kesh këtë apo atë emërtim.

Si një mysliman shembullor dhe ideal që e adhuronte Allahun dhe u shërbente njerëzve me dashuri, le të paraqesim një tablo nga jeta e të ndjerit, Hz. Abdulaziz Bekkine prej Kazani, me qëllim që të prezantojmë një jetë shembullore për të gjithë. Kjo tablo është marrë nga libri i Emin Eshëkut:

“Hz. Abdulazizi ishte një person i ditur dhe i urtë nga turqit tatarë të Kazanit. Ai ishte edhe shehu i hoxhës tonë të ndjerë M. Zahitit. Pas revolucionit bolshevik të vitit 1917, ai la atdheun së bashku me motrën e tij dhe erdhi në Stamboll pas një udhëtimi të gjatë dhe të mundimshëm dhe u vendos në një fermë në Alibejkëj. Pas një kohe të caktuar, u bë imam i xhamisë Zejrek në lagjen Fatih. Mirëpo, ai nuk e shpenzonte as një qindarkë nga paga e tij si imam për shtëpinë e tij dhe nuk e ushqente familjen e vet me të. Duke thënë: “Në lagje ka njerëz që janë më të varfër dhe më nevojtarë se ne.”, ua shpërndante të gjithë rrogën të varfërve të lagjes. Ai i këshillonte dhe u jepte moral anëtarëve të familjes së tij duke u thënë: “Ne tashmë jetojmë në shtëpinë e xhamisë, andaj e kemi për detyrë ta kryejmë namazin në këtë xhami si imam edhe pse nuk marrim asnjë rrogë, falë Zotit, kemi punë të tjera për të bërë.”

Çdo javë shkonin në treg, blinin disa kilogramë lesh dhe e tjerë në shtëpi. Pastaj thurnin çorape bashkë me gruan dhe fëmijët. Ato çorape i shisnin në tregjet e lagjes përmes tregtarëve që i njihnin. Ai thoshte: “Nuk është hallall që paratë të cilat i marrim nga xhamia t'i shpenzojmë për vete ndërkohë që në lagje ka të sëmurë dhe të moshuar që nuk bëjnë asnjë punë.” Paratë që merrte si rrogë në ato vite ishin rreth tridhjetë e dy lira. (Midis viteve 1939-1945, imamët dhe myezinët merrnin kaq para si rrogë.)

Aziz Efendi ishte si ndihmuesi i të gjithëve, i madh e i vogël, i pasur e i varfër. Ai që kishte ndonjë problem fillimisht shkonte tek ai, i tregonte për

problemin e tij dhe merrte këshilla prej tij. I ndjeri Gënenli Mehmet Efendi ishte gjithashtu një person si vakëf-fondacion më vete. Një fshatar i varfër nga Bajburti që dëgjo për bujarinë e Aziz Efendiut, e mori në shpinë djalin e tij katër vjeçar në mes të dimrit dhe shkoi te hoxha i nderuar. Atij i tha: «Hoxhë, ky është djali im, atë e ka kapur poliomyeliti. Doktorët te ne nuk mundën t'i gjenin një kurë. Ata që të njohin ty më thanë: “Çoje këtë fëmijë në Stamboll, atje është një hoxhë, ai do ta trajtojë atë. Sepse ai njuh mjekë të mëdhenj. Ata do të kujdesen për këtë fëmijë për hir të hoxhës. Edhe unë e mora dhe e solla këtu te ju.» Kështu ia dorëzoi fëmijën hoxhës. Pastaj u largua duke i thënë: «Do të vij ta marr më vonë.» Ai shkoi për ta marrë fëmijën vetëm pas katër muajsh.

Aziz Efendi gjatë gjithë dimrit u kujdes për fëmijën sikur të ishte djali i tij. Pas çdo namazi të mëngjesit, ai e pastronte me duart e veta fëmijën, i jepte për të ngrënë e për të pirë dhe e vishte. E mbështillte fort që të mos ftohej e sëmurej, e merrte fëmijën në shpinë edhe pse ishte borë e dimër, e çonte nga Zejreku në spitalin e Xherrahpashës, e merrte dhe e çonte çdo ditë ose çdo pasdite duke thënë se ishte amanet. Shumicën e herëve nisej herët në mëngjes për të kapur namazin e drekës. Atyre që i thoshin: “Hoxhë, mos u shqetësoni. Sido që të ndodhë, dikush nga xhemati do të bëhet imam dhe do të prijë në namaz.”, ai u përgjigjej: «Kjo nuk bën. Ajo detyrë na është dhënë neve. Mihrabin e kemi amanet.»

Ata që e donin hoxhën mërziqeshin kur njerëzit e përdornin dhe e shfrytëzonin kështu. Andaj i thoshin: “Hoxhë, ju silleni shumë butë ndaj njerëzve. Ju silleni mirë ndaj tyre, kurse ata e shfrytëzojnë vullnetin tuaj të mirë dhe përpiqen t'ju bëjnë t'ua kryeni të gjitha punët e tyre. Thoni pak jo, nuk mundem, edhe unë kam punë, mësoni të thoni jo.” Hoxha u përgjigjej kështu këtyre:

«Propozimi është për ne. Pavarësisht se nga kush apo prej nga vjen, ne e dimë se vjen nga Allahu.»

Fetarizmi i vërtetë nuk është barrë, por kënaqësi. Nuk ka asgjë si kënaqësia e një adhurimi të bërë me dashuri. Transmetohet se Hz. Sulejman Darani ka thënë: “Nëse xheneti do të ishte në një rënë anë dhe namazi në anën tjetër, unë do të preferoja namazin. Te xheneti është interesi im, kurse te namazi është kënaqësia e Allahut (xh.xh.). Unë preferoj kënaqësinë e Zotit.”

Allahu mos na privoftë nga adhurimet plot dashuri.

Të jesh mirënjohës ndaj Zotit (xh.xh.)

— Omer Çelik —

“Kur arritën në Luginën e Milingonave, një milingonë tha: “O milingona, hyni në banesat tuaja, që të mos ju shkelë Sulejmani dhe ushtria e tij, duke mos ju parë!” Ai vuri buzën në gaz, duke qeshur me fjalët e saj dhe tha: “O Zoti im, më frymëzo që të jem mirënjohës për mirësitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi, dhe që të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur. Më prano, me mëshirën Tënde, në gjirin e robërve të Tu të devotshëm!” (Neml, 18-19)

Sulejmani (a.s.), kishte një ushtri të madhe që përbëhej prej xhindësh, njerëzish dhe zogjsh. Një ditë, këta u mbloodhën në një ushtri të rregullt para Hz. Sulejmanit për një luftë dhe filluan të marshonin. Ai që i administronte dhe udhëhiqte këta ishte vetë Sulejmani (a.s.). E gjithë ushtria, me të djathtën dhe të majtën, me pjesën e përparme dhe të pasme, çetat dhe divizionet, lëvizte dhe përparonte sipas urdhrit të tij. Më në fund, ata arritën në «luginën e milingonave». Këtu ishte një luginë plot me milingona. Ngaqë Kurani Fisnik nuk e ka konsideruar të nevojshme për ta specifikuar se ku ndodhej kjo luginë dhe se për çfarë lloj luginë bëhet fjalë, edhe ne nuk do të harxhojmë shumë kohë duke dhënë detaje. E rëndësishme është situata dhe e folura e prijësit të milingonave, dhe kuptimi i këtyre nga Hz. Sulejmani, fakti që bota shpirtërore e tij nxitoi drejt Allahut si një ujëvarë përballë kësaj mirësie hyjnore që i ishte dhuruar dhe bërja e lutjes së tij madhështore, përmbajtja, thellësia dhe bukuria e së cilës do ta udhëheqin shpirtin e njeriut deri në Ditën e Gjykimit. Në të vërtetë, gjendja që shihet në këtë ngjarje shembullore është një nga projeksionet

e së njëjtës ndjeshmëri shpirtërore të manifestuar në epokat e mëvonshme:

Një ditë Kanuni Sulltan Sulejmani, kërkoi një fetva nga Shejhul-Islami Ebu's-Suud Efendi për mbytjen e milingonave që thanin pemët e dardhave në kopshtin e sarajit, me një bejte si më poshtë:

“Nëse milingona e dëmton pemën dhe e than,
A ka ndonjë të keqe nëse e shfaros atë?”

Pas kërkesës së Sulltanit për këtë fetva, Ebu's-Suud Efendi u përgjigj kështu me një bejte:

“Kur të arrijë nesër në audiencën e Zotit;
Milingona e merr hakun e saj nga Sulejmani!”

Kur ushtria arriti në luginën e milingonave, prijësi i milingonave i paralajmëroi të gjitha milingonat që gjendeshin atje: «Të mos ju shkelin pa u vënë re Sulejmani dhe ushtria e tij.» Çështja që bie në sy këtu është se milingona e njihte Hz. Sulejmanin dhe ushtrinë e tij. E dinte se ata ishin besimtarë, njerëz të drejtë, të mëshirshëm dhe të butë. Andaj dëshmonte se ata ishin njerëz të butë dhe të virtytshëm që nuk shtypnin me vetëdije as një milingonë të vogël dhe e mbronin të drejtën e saj.

Me bejten e mëposhtme poeti shpreh bukur se mbrojtja e të drejtave të të gjitha qenieve dhe dhënia e së drejtës secilit posedues të saj është një rregull i domosdoshëm për një jetë shoqërore në paqe:

“Përfitimi i masës nuk mund ta anulojë të drejtën e individit,

Andaj mos e shtyp një individ, nëse bëhet fjalë për përfitime të masës.” (Naili Xhedid)



Që do të thotë: “Mos pandeh se duke u hequr të drejtat disa njerëzve apo një grupi, do të kënaqësh një popull të tërë! Nëse dëshiron të kënaqësh një popull të tërë, nuk duhet të shtypësh qoftë edhe një person të vetëm mes tyre.”

Nga fjalimi i milingonës mund të nxirret një she-një e tillë: “Unë e inkurajoj popullin tim të jetë asket kundrejt kësaj bote. Nëse do t’ju shihnin me këtë pasuri dhe salltanet, pata frikë se do t’i kërkonin edhe ata, prandaj i urdhërova të hynin në shtëpitë e tyre, në mënyrë që të mos u dëmtohej ndjenja e asketizmit.” Nëse e pranojmë këtë shpjegim si të saktë, këtu tërhiqet vëmendja ndaj detyrave të të mëdhenjve për drejtimin e fëmijëve, familjeve dhe komuniteteve të tyre drejt së mirës. (Kushejri, Letaifu’l-isharat, II, 414.) Faktikisht është e qartë se ka dëshmi në ajet që është e nevojshme të mbrohem në mënyrën më të mirë nga rreziqet prej të cilave frikësohemi se mund të ndodhin. Qeniet e gjalla, si domosdoshmëri e natyrshmërisë së tyre, e kanë një potencial të tillë vëmendjeje dhe kujdesi.

Bejtja e mëposhtme e Zija Pashës mbart gjithashtu këtë kuptim:

“Thonë se froni i Sulejmanit fluturonte në ajër,

Në atë vend të atij mbretërimi tashmë fryjnë erë-ra.”

Hz. Sulejmani e dëgjoi fjalimin e milingonës dhe e kuptoi se çfarë donte të thoshte. Ky fjalim e kënaqi shumë atë, andaj u gëzua dhe u ndje mirë. U gëzua në të njëjtën mënyrë që një fëmijë i vogël përpiket të shpëtojë nga një njeri që është në gjendje ta ndëshkojë menjëherë dhe si të dojë. Për këtë arsye buzëqeshi ëmbël duke u ndjerë i lumtur. Megjithatë, ky gëzim dhe buzëqeshje nuk ishin për shkak të ndonjë suksesi të kësaj bote, por një manifestim i admirimit që ndjehet ndaj mirësisë së dijes dhe mirësisë shpirtërore. Për këtë arsye, përballë kësaj mirësie hyjnore, Sulejmani (a.s.), iu drejtua Allahut të Plotfuqishëm me gjithë qenien e tij, pa anuar aspak nga ndjenjat vetjake dhe iu përgjërua:

«...O Zoti im, më frymëzo që të jem mirënjohës për mirësitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi, dhe që të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur. Më prano, me mëshirën Tënde, në gjirin e robërve të Tu të devotshëm!»
(Neml 27/19)

Me këtë lutje, Sulejmani, alejhi’s-salam, para-shtroi këto tri kërkesa të rëndësishme ndaj Zotit (xh.xh.):

E para: T’ia mundësojë të jetë mirënjohës për mirësitë që i ishin dhënë si atij ashtu edhe prindërve të tij. Sepse Allahu i Madhëruar kërkon nga robërit e Tij mirënjohje dhe përgëzon se do t’ua shtojë mirësitë atyre që janë mirënjohës, ndërkohë na bën me

dije se robërit mirënjohës janë shumë të paktë në numër.

Nga ana tjetër, nuk i pëlqen kurrrë mosmirënjohja dhe deklaroi se do t’i ndëshkojë ata që shfaqin mosmirënjohje. (shik. Ibrahim, 7; Sebe’, 13.) Sipas kësaj, falënderimi i Zotit është një mirësi e madhe. Fakti që Sulejmani (a.s.), përfshiu në lutjen e tij mirënjohjen për mirësitë e dhëna ndaj «prindërve» të tij, tregon se robi duhet të jetë mirënjohës ndaj Zotit jo vetëm për mirësitë e specifike të tij, por edhe për të gjitha mirësitë specifike dhe të përgjithshme të dhëna nga Allahu (xh.xh.).

E dyta: Mundësia për të bërë vepra të mira me të cilat Allahu i Madhëruar do të jetë i kënaqur. Është sukses i madh që të gjitha qëllimet, fjalët, veprimet dhe sjelljet e robit të jenë në pajtim me pëlqimin e Allahut Teala. Njeriu që ia del mbanë në këtë çështje, do të jetë në gjendje edhe të qëndrojë larg nga gjërat që e zemërojnë Allahun (xh.xh.). Megjithatë, rëndësia për vazhdimin në një lutje të tillë është e qartë, pasi që vetëm Allahu është Ai që do t’ia japë këtë robit të Tij.

E treta: Mundësia për të hyrë në mesin e robërve të devotshëm me mëshirën e Allahut, kërkimi i fundit të mirë. Ajo që nënkuptohet me fjalën «salah» këtu është të arrish mëshirën e të Gjithëmëshirshmit pa asnjë njollë mëkati. Është e domosdoshme që njeriu të gjendet në mesin e të devotshmëve dhe të sinqertëve, në mënyrë që të vazhdojë me gjendjen e mirë të tij, të përmirësojë moralin gradualisht, të rrisë besnikërinë dhe sinqeritetin në adhurim dhe të arrijë Zotin e tij me një përfundim të mirë. Ata që janë miq me robërit e devotshëm dhe të sinqertë në këtë botë, do të hyjnë me ta në xhenet edhe në botën tjetër. Për këtë arsye, edhe robërit më të dalluar, profetët, e lutën Allahun e Madhëruar që të jetë me të devotshmit. Kështu, Jusufi (a.s.), iu përgjërua Zotit:

«O Zot! Ma merr jetën time si mysliman dhe më fut në mesin e robërve të Tu të devotshëm!»
(Jusuf, 101)

Nisur nga rëndësia e kësaj, Allahu i Madhëruar thotë:

«O ju që keni besuar! Kujdes nga kundërshtimi i Allahut dhe qëndroni me njerëz, të cilët janë të devotshëm, të sinqertë dhe të ndershëm!» (Tevbe, 119)

Kjo gjendje shpirtërore sublime e nxjerrë në pah nga lutja e Sulejmanit (a.s.), gjatë periudhës më madhështore të mbretërimit dhe salltanetit të tij, përmban mësim shumë të rëndësishme që do t’i frymëzojnë shtetarët të cilët duhet të jenë shembull për shoqërinë e tyre në të gjitha llojet e virtyteve.

Harami ka ndëshkim

HALLALLI KA LLOGARI

— Abdullah Sert —

Nga të gjitha begatitë dhe mundësitë që Allahu Teala ua ka dhuruar robërve të tij, ato të lejuarat na janë vënë në dispozicion dhe është siguruar një balancë me urdhrat për të mos rënë në shpërdorim, për të qenë altruist dhe për të shpenzuar në rrugë të Zotit (xh.xh.). Veçanërisht shprehja e të mëdhenjve të Islamit, të cilët njihen si Selefi Salihin, në formën: “Harami ka mëkat dhe dënim, kurse hallalli ka llogari.”, duhet të jetë një kriter jete për të gjithë besimtarët.



«Bëni kujdes, unë jam Habibullah (i Dashuri i Allahut), por prapë se prapë nuk ka mburrje!» (Tirmidhi, Menakib, 1/3616; Darimi, Mukaddime, 8.)

Nga të gjitha begatitë dhe mundësitë që Allahu Teala ua ka dhuruar robërve të tij, ato të lejuarat na janë vënë në dispozicion dhe është siguruar një balancë me urdhrat për të mos rënë në shpërdorim, për të qenë altruist dhe për të shpenzuar në rrugë të Zotit (xh.xh.). Veçanërisht shprehja e të mëdhenjve të Islamit, të cilët njihen si Selefi Salihin, në formën: “Harami ka mëkat dhe dënim, kurse hallalli ka llogari.”, duhet të jetë një kriter jete për të gjithë besimtarët.

Modeli i jetës të cilin e dëshiron dhe është i kënaqur Allahu i Madhëruar është formësuar në jetën e bekuar dhe shembullore të të Dërguarit të Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të. Ndërsa Profeti (a.s.), e kreu detyrën e përcjelljes së urdhrave hyjnore për të cilat ishte përgjegjës, ashtu siç ishte urdhëruar, ai shfaqti edhe shembujt më të përsosur të sjelljes si një rob i Zotit. Allahu i Madhëruar e prezantoi Habibin e Tij si “një i dërguar nga komuniteti në të cilin jeton, i cili është i dashur për umetin e tij, të cilit i vjen shumë rëndë kur ata përballen me vështirësitë dhe i cili është i butë e i mëshirshëm”. (Shik. Tevbe, 128.) Si shembull i gjallë i këtij përshkrimi hyjnor, i Dërguari i Allahut (a.s.), i përcillte gjithmonë nga afër kushtet dhe mundësitë

e jetës së shoqërisë në të cilën jetonte, bënte një jetë të thjeshtë dhe kurrë nuk ishte i prirë të fitonte për vete mundësi që shokët e tij të dashur nuk i kishin dhe të jetonte ndryshe nga ata.

Allahu i Plotfuqishëm me manifestimet el-Basit/dhënës i rrëskut me bollëk dhe el-Kabid/ngushtuesi i mirësive të Tij ndonjëherë, ndërsa nganjëherë u jep robërve të Tij mundësi dhe bollëk, nganjëherë tjetër i sprovon ata me vështirësi, telashe, sprova të pasurisë dhe jetës. Shembujt më të mirë të sjelljes për të dyja situatat gjenden në jetën e Profetit, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të.

Herë pas here njerëzve u vjen në mendje se cila nga sprovat, domethënë ajo e varfërisë apo ajo e pasurisë, është më e vështirë? Edhe pse të qenët i kënaqur me situatën dhe durimi janë thelbësore në kohë telashesh dhe vështirësish, kjo situatë faktikisht është e pavullnetshme në një farë mënyre. Kurse frenimi i dëshirave të nefsit dhe vendosja e kufijve ndaj dëshirave si lakmia dhe tamahu përgjatë periudhave kur mundësi të ndryshme shtrohen para njerëzve me bollëk, është një gjendje që varet nga një edukim shpirtëror dhe një vullnet i fortë.

Nga të gjitha begatitë dhe mundësitë që Allahu Teala ua ka dhuruar robërve të tij, ato të lejuarat na janë vënë në dispozicion dhe është siguruar një balancë me urdhrat për të mos rënë në shpërdorim, për të qenë altruist dhe për të shpenzuar në rrugë të

Zotit (xh.xh.). Veçanërisht shprehja e të mëdhenjve të Islamit, të cilët njihen si Selef i Salihin, në formën: “Harami ka mëkat dhe dënim, kurse hallalli ka llogari.”, duhet të jetë një kriter jete për të gjithë besimtarët.

Kur shqyrtohet jeta 63-vjeçare e të Dërguarit të Allahut (a.s.), 23 vitet e së cilës kaluan si i Dërguar i Allahut, shohim se ai preferonte kryesisht thjeshtësinë, asketizmin dhe mjaftimin me atë që i kishte dhënë Allahu. Shohim se ai ndjehej i lumtur me kënaqësinë që ia jepte jetesa jo e ndryshme nga e shokëve të tij duke ndarë me umetin çdo gjë që kishte.

Si burimet kryesore të haditheve ashtu edhe veptrat e shumta të Sijeri Nebi që janë shkruar për Profetin deri më sot, janë të mbushura plot e përplot me shembuj të panumërt se si i Dërguari i Allahut (a.s.), preferonte një jetë të thjeshtë për veten e tij dhe se si ishte burim i bamirësisë dhe mëshirës për umetin.

Këta informacione të rëndësishme që gjenden në «Shifai Sherif» të Kadi Ijazit (l. 1083, v. 1149, Marok), i cili është një burim i rëndësishëm dhe i përgjithshëm për të Dërguarin e Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, nxjerrin në pah qartazi këndvështrimin profetik për këtë çështje.

“Le t’i hedhim një vështrim sjelljes dhe moralit të të Dërguarit të Allahut (a.s.), lidhur me pasurinë. Allahu i Madhëruar i kishte dhuruar Atij thesaret e tokës dhe i kishte dhënë çlirimin e vendeve. Ndërsa ai ishte ende gjallë, disa nga territoret e Hixhazit, Jemenit, Sirisë dhe Irakut ishin çliruar. Një e pesta e plaçkës së luftës e fituar në këto çlirime dhe paratë e zekatit të mbledhura nga myslimanët e pasur ishin aq të shumta saqë asnjë sundimtar nuk mund t’i mblidhte kaq shumë para.

Përveç kësaj, mbretërit e huaj i dërgonin edhe dhurata të ndryshme Resulullahut, alejhi’s-salam. Por ai nuk merrte asgjë nga të gjitha këto, qoftë edhe një dërrhem të vetëm, për vete dhe familjen e tij. Ato i shpenzonte aty ku duheshin shpenzuar, i pasuronte të tjerët dhe i forconte myslimanët në çdo mënyrë.

Një herë, atij i erdhën shumë florinj, por ai la vetëm gjashtë dinarë, ndërsa të gjithë ua shpërndau nevojtareve. Pasi ia la amanet ato gjashtë dinarë njëres nga bashkëshorteve të tij, shkoi të pushonte. Por atë nuk e zuri gjumi në asnjë mënyrë. Andaj u ngrit nga shtrati dhe pasi i shpërndau ato para, tha: «Tani ndjehem i lehtësuar.»

I Dërguari i Allahut (a.s.), mjaftohej me ushqij-

min, veshmbathjen dhe atë që ishte absolutisht e nevojshme për shtëpinë dhe nuk kërkonte më shumë. Ai vishte rrobën që gjente dhe mjaftohej me një pëlhurë (shemle), një rrobë të endur trashë dhe një rrobë të trashë me vija, me të cilat shpesh mbështillej dhe mbulohej. Sepse të veshësh rroba të shtrenjta dhe sidomos të mburrësh me to nuk është diçka që tregon vlerë dhe nder njerëzor. Rroba më e mira është rroba e pastër, ajo që nuk është shumë e shtrenjtë dhe jo shumë e lirë.

Në përgjithësi konsiderohej e keqe të veshësh rroba të shtrenjta dhe të mburrësh me to. Edhe njerëzit në të njëjtën mënyrë nuk e konsiderojnë të mirë mburrjen me rrobat dhe me pasurinë e shumtë. Gjithashtu është e pakëndshme të mburrësh me bukurinë e shtëpisë, me morinë e sendeve shtëpiake, me shërbëtorët dhe me kafshët e transportit.” (Shifai Sherif, I/214-216.)

Sahabët e epokës së lumturisë, të cilët ndoqën gjurmët e të Dërguarit të Allahut (a.s.), në çdo çështje me dashurinë dhe botëkuptimin: «Përndërit tanë të qofshin falë ty!», gjithashtu u përpoqën të jetonin atë që panë prej tij dhe të mos i ndanin rrugët e tyre nga ai në këtë botë dhe në botën tjetër. Meqenëse Hz. Omeri duhej të linte punët e veta për shkak të detyrës së kalifatit, vajza e tij Hz. Hafsa i bëri një kërkesë për rritje rroge ngaqë familja kishte rënë në vështirësi, por Hz. Omeri (r.a.), pasi përshkroi se si Profeti jetoi një jetë të thjeshtë, iu përgjigj asaj:

«Bija ime! Shembulli im janë i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe Hz. Ebu Bekri. Ne të tre jemi si tre shokë që ecin në të njëjtën rrugë. I pari nga këta, i Dërguari i Allahut (a.s.), mori pak ushqim me vete dhe arriti në vendin e tij. Edhe i dyti mori rrugën e të parit dhe arriti tek ai. Sa i përket të tretit, mua, do t’i arrijë nëse e ndjek rrugën e atyre të dyve, por nëse devijoj në një rrugë tjetër, nuk do t’i arrijë ata përgjithmonë.» (Fedaili A’mal, 54.)

Tani është shumë e vështirë të jetosh si ata, kemi shumë të pengesa brenda dhe jashtë nesh. Sidoqoftë, dëshira dhe entuziazmi për t’i pasuar ata në një kuptim absolut nuk duhet të humbasë kurrë. Njohja e tyre kështu në këto ditë e sotshme kur kënaqësitë dhe ambiciet e kësaj bote kanë arritur në kulmin e tyre, do t’i pakësojë ndjenjat tona të lakmisë, tamahut, shpërdorimit dhe shtirjes, të cilat nuk po mund t’i kontrollojmë, dhe do të sigurojë formimin e masave të duhura dhe maturinë brenda nesh.



Kushdo që të vijë është i përkohshëm

— Bestami Jazgan —

Ne duhet të ndjekim të përjetshmen, jo të rendim për t'u bërë të përjetshëm. Ata që jetojnë sikur nuk do të vdesin kurrë, vdesin sikur të mos kishin jetuar asnjëherë. Çdo fillim e ka një fund. Kushdo që vjen, është i përkohshëm. Nëse nuk e harrojmë se kemi ardhur nga Zoti, do të shkojmë tek Zoti....

Të nderuar! Le të lidhim trëndafila në perin e fjalëve. Le të themi të vërtetën dhe të shkruajmë të vërtetën. Le të ecim me njerëz të mirë në kopshtin e dashurisë. Le të bëhemi dashuri dhe të depërtojmë në zemra.

- Miq, poeti thotë se në këtë botë mbesin vetëm pendimet. Po ju çfarë thoni?

- Çdo gjë që ka një fillim, ka edhe një fund. Mendja ime thotë kështu. E rëndësishme është se si do ta mbushim kohën mes fillimit dhe fundit.

- E the shumë mirë mendje. Çfarëdo që të mbjellësh në tokë, ajo do të të vijë në kokë. Nëse mbjellim farën e së keqes, do të pendohejmë, nëse mbjellim farën e së mirës, do të korrim elhamdulillah.

- Ndërsa po flisnit shumë bukur, e lidhët punën me pendimin e pishmanllëkun, hallall ju qoftë. More vëlla, pse ju vijnë në mendje këto gjëra kur ka kaq shumë mirësi të Allahut (xh.xh.)?

- Edhe unë jam i të njëjtit mendim me ty, vëlla nefs. Pavarësisht nëse gjithçka është mirë apo jo, paraardhësit tanë kanë thënë: «Çfarë të mbjellësh, atë do të korrësh.» Nëse mbjellim trëndafila, do të marrim trëndafila, nëse mbjellim ferra, do të marrim ferra...

- Ke të drejtë mendje. Kjo botë është ara e botës tjetër. Do të mbjellim, do të korrim. Do të përgatisim ushqimin dhe do të nisemi për rrugë.

- Mojm zemër, nuk u paskan hije fare këto fjalë. Edhe në udhëtimin për në ahiret, po përpiqesh të marrësh ushqim nga këtu. A nuk ka më të mirat nga të gjitha mirësitë në xhenet?

- Nëse kemi garanci se do të shkojmë në xhenet, ke të drejtë o nefs. Mëkatet tona janë barrë, veprat tona të mira janë ushqim. Nëse nuk shpërtojmë dot

nga barra në këtë udhëtim, do të jetë shumë keq për ne.

- O të nderuar! Poeti thotë se edhe pozita dhe autoriteti janë gënjeshtër.

- Nuk duhen besuar shumë këto fjalët e poetëve. Me një urdhër e kthejnë botën në rrëmujë, me një urdhër e kthejnë në kopsht trëndafilash. Unë i dua shumë pozitën dhe gradën. Nëse arrij t'i marr, nuk ia lë më askujt.

- Epo, miku im, ne shohim saraje të rrënuara në të gjithë botën Pse u larguan poseduesit e tyre?

- Ke të drejtë, mendje. Zija Pashai thotë: "Në vendin ku mbretëroi Sulejmani / Tashmë fryjnë erërat aty." Vetëm se vëlla nefsi ka të drejtë në njëfarë mënyre. Nëse e përdorni fuqinë nën urdhrin e së drejtës dhe formoni fron në zemrat e njerëzve, pozita dhe grada do të jenë të dobishme.

- Unë nuk mund të pranoj të zhdukem, miq! Edhe nëse vdes, do të ndërtoj një varr të madh dhe do të kem një gur varri të zbukuruar në krye të varrit. Aty do të shkruaj me germa të mëdha: «Këtu prehet sulltani nefsi.»

- O nefsi! Më thuaj, ku është varri i gjyshit të gjyshit tënd?

- Epo, nuk e di, por patjetër që ka një gur të madh në krye.

- Mos e orvat veten me gurë kot, i dashur nefsi. Ne po përpiqemi të shpëtojmë nga barra, kurse ti po përpiqesh të mbushësh me gurë brenda dhe jashtë.

- Faleminderit mendje. Ne duhet të ndjekim të përjetshmen, jo të rendim për t'u bërë të përjetshëm. Ata që jetojnë sikur nuk do të vdesin kurrë, vdesin sikur të mos kishin jetuar asnjëherë. Çdo fillim e ka një fund. Kushdo që vjen, është i përkohshëm. Nëse nuk e harrojmë se kemi ardhur nga Zoti, do të shkojmë tek Zoti...

Njeriu përsoset me njeriun

— Dr. Adem Ergyl —

Në ditët e sotme, ne si familje e njerëzimit, madje si umet i Islamit, kemi jashtëzakonisht shumë nevojë për «Shembullin e Myslimanit të Devotshëm» i cili shfaqet në personin e profetëve. Është e qartë se njerëz të tillë na duhen si buka dhe uji në lagjen tonë, në fshatin tonë dhe në qytetin tonë, si yjet e shndritshëm që na ndihmojnë të gjejmë rrugën në natën e errët. Nëse njerëzit e devotshëm zhduken, njerëzimi e humbet thelbin e tij të humanizmit. Adresa e rilindjes është kapitali ynë njerëzor, i cili zbukurohet me besim, islam dhe dashamirësi. Përmbushja e kësaj nevojë është obligim për umetin Islam, sepse amaneti i Islamit është mbi ne ngaqë ne jemi umeti i profetit të fundit. Ajo që duhet bërë është që çdo mysliman të jetë i vendosur të bëhet një njeri i mirë duke i përdorur aftësitë dhe talentet e veta maksimalisht në fushën e tij.

Është e qartë se kemi nevojë për shembuj të mirë në çdo fushë: Kemi nevojë për dijetarët që japin shembull me diturinë, veprat, moralin dhe xhihadin e tyre;

Për të urtët që udhëheqin rrugën si një yll polar me vitalitetin e zemrës, mençurinë, dhembshurinë dhe mëshirën e tyre, dhe mbi të gjitha, sjelljen dhe qëndrimin e tyre;

Udhëheqës të besueshëm dhe të matur me ndërgjegje për drejtësi dhe përgjegjësi;

Për njohës të tregtisë dhe industrisë që janë të ndershëm, që i frikësohen Allahut, që dridhen nga ndjeshmëria ndaj kafshatës hallall dhe që kujdesen për interesat e shoqërisë;

Për prindër që janë shembullorë dhe të denjë për çdo respekt, që e shndërrojnë shtëpinë e kësaj bote në një parajsë;

Për mësues që ia kanë dedikuar zemrën detyrës së tyre dhe e përmëshurin atë me dashurinë për të mbrojtur dhe përmirësuar brezat;

Për artistët që ia shtojnë vlerën shoqërisë me delikatesën, mirësinë dhe hirin e tyre dhe që krijojnë vepra të përhershme në ndërtimin e qytetërimit;

Dhe për shumë më tepër njerëz të mirë si këta në pothuajse çdo fushë.

Është e vështirë që idetë e mira pa shembuj të gjallë të kenë ndikim dhe të marrin jetë. Ide të tilla mund të mbijetojnë në rreshtat e librave si dëshira boshe, por nuk mund ta lartësojnë njeriun gradualisht dhe të ndërtojnë qytetërim. Ngritje dhe ndërtime të tilla mund të realizohen vetëm nën orientimin e shembujve dhe udhëheqësve të tillë.

Nevoja për shembull është një nevojë për përsosje e çdo moshe dhe çdo nivel. Sa kapital i madh është të kesh shembuj të gjallë nëpërmjet të cilëve mund të plotësohet kjo nevojë. Ata që nuk kanë një kapital të tillë duhet të paktën të mos neglizhojnë të ushqehen me shembuj që janë përjetuar.

Mirë se erdhët pushimet e verës!

— Psik. Tuba Sëkmen —

Provimet, testet, ushtrimet, detyrat e shtëpisë, detyrat e paraqitjes... Pothuajse jemi lodhur edhe ne sa fëmijët. Cili do qoftë përfundimi, sidoqoftë u mbyll edhe një semestër. Tashmë ka ardhur koha që për një kohë t'i vëmë në raft fletë-provimet, testet, shënimet dhe t'i argëtojmë e qetësojmë pak fëmijët tanë.

Që nga fillimi i sezonit, nxënësit nganjëherë genë të suksesshëm, nganjëherë jo, por është më se e vërtetë se punuan me një ritëm shumë të ngjeshur. Ata u rritën një klasë më shumë, ndërsa ne prindërit u plakëm një vit më shumë.

Gjithsecili reflektoi diçka në shkollë; pati edhe përjetime të fshehta pas reflektimeve... Ndonjëherë i ndanë me ne ndodhitë e shkollës, ndonjëherë i mbajtën përbrenda zhgënjimet, grindjet me shokët, shqetësimet e tyre autoritare, ndjenjat e pamjaftueshmërisë... Ana e dukshme e punës së tyre në të shumtën e kohës për ne ishin notat në dëftesë. Ato që në një çast mund të na bënin të përjetonim lumturi apo të na e rrudhnin fytyrën... Shifrat në dëftesë të cilat janë aq ndikuese, saqë t'i kthejnë përjetimet në një boshllëk të madh shpirtëror... Cilado qoftë vlera e notave që na reflektohet ne, nxori në pah përpjekjen e mundshme të të gjithë fëmijëve dhe të gjithë e meritojnë një copë pushim larg stresit të shkollës.

Fëmijët i meritojnë pushimet, por fjala “pushime” nuk duhet të konceptohet si gjendje pasiviteti. Pushimet janë një kohë e dhënë për fëmijët, që ata të rrisin sukseset për semestrin e ardhshëm.

Nëse përgjatë tre muajve të periudhës së “Pushimeve verore” fëmijëve u kultivohet një ambient përtacie, nëse ata gjatë kësaj kohe nuk kanë asnjë aktivitet mendor dhe fizik, fëmijët nuk mund të përgatiten në një mënyrë të shëndetshme për sezonin e ri mësimor. Dembelizmi gjatë pushimeve, përveç se i bën ata të pushojnë, bëhet shkak që ata të humbasin dinamizmin e të menduarit dhe të mësuarit që fituan gjatë periudhës mësimore.

Misioni i pushimeve është një kohë që thyen vazhdimësinë në zakone dhe mundëson kthimin e vullnetshëm në punën e bërë. Humbja e aftësive që bëhet gjatë këtij pushimi, por që janë të domosdoshme për punën, e pakëson frytin. Nëse fëmija e fillon shkollën duke kaluar tre muaj pa lexuar asnjë libër apo gazetë, pa e vënë në punë trurin, vetëm duke ndjekur televizor apo mbi kompjuter, do t'i dobësohen aftësitë e të mësuarit.

Përkundrazi, ata duhet t'i ushtrojmë në aktivitetet që duan t'i provojnë në pushimet verore ngaqë nuk kanë programe të ngjeshura dhe ngaqë nuk kanë pasur kohë në periudhën e shkollës, po ashtu, duhet t'ua shtojmë dijenitë e eksperiencat

në këto fusha. Fëmijët duhet t'i inkurajojmë që të lexojnë sa më shumë në këtë periudhë, t'u mundësojmë vazhdimësinë në të mësuar e menduar dhe në këtë mënyrë të mbështesim vazhdueshmërinë e aftësive të tyre.

Komuniteti mysliman hap kurse Kurani që fëmijët tanë të përfitojnë në muajt e verës dhe duke i bashkuar fëmijët e një lagjeje apo të një fshati, prezanton një shërbim edukimi publik. Fëmijët që shkojnë në kurse Kurani gjatë pushimeve verore, duke marrë mësim në një fushë të ndryshme brenda një programi dhe disipline të caktuar, mund të mbajnë gjallë aftësitë e të mësuarit dhe të zhvillojnë aftësitë e të mësuarit përmendsh.

Në të njëjtën kohë, duke u mbledhur së bashku me moshatarët, mund të plotësojnë nevojën e lojës dhe mund të mësojnë të mblidhen bashkë për kënaqësinë e Allahut. Fëmijët të cilët gjatë verës shkojnë nëpër kurse Kurani, kanë mundësi të zhvillojnë aftësitë e tyre mendore dhe sociale.

Veçanërisht përgjegjësitë që kemi hezituar t'ua japim duke u shqetësuar se mos neglizhojnë mësimet kur shkollat janë hapur, mund t'u jepen në kohën e pushimeve. Vajzat duhet të njihen me rolet sociale që priten nga zonjat dhe t'u jepen detyra sipas moshave në punët e shtëpisë. Në këtë mënyrë duhet të mbështetet lidhja nënë e bijë. Ndërsa djemtë duhet të njihen me rolet sociale që priten nga kryefamiljarët. Djemtë në kushte të për-

shtatshme bashkë me babanë ose me ndonjë burrë të rritur të familjes mund të shkojnë në vendin e punës së tyre dhe të njihen me profesione si tregtia, mjeshtëria, prodhimtaria, në këtë mënyrë mund të rritet komunikimi babë e bir. Nuk duhet të harrohet se, nëse fëmijëve u ngarkohen detyra sipas moshës që kanë, u rritet vetëbesimi.


Meqë këtë vit tre muajt e bekuar kanë rënë në pushimet verore, duhet të vlerësohen si rast i mirë për fëmijët dhe të rinjtë tanë. Me sofrat e iftareve që ndajmë me familjen dhe miqtë tanë, duhet t'i inkurajojmë fëmijët për të agjëruar. Prindërit nuk duhet të shqetësohen kur fëmijët janë fizikisht të uritur, por kur shpirti i tyre është i pangopur.

Në mbrëmjet e gjata të verës, duhet t'i marrim ata bashkë me shokët në namazin e teravive dhe t'u mundësojmë që të përjetojnë faljen e namazit me xhemat. Në ndihmat që u bëjmë të varfërve dhe të vetmuarve, duhet t'i bëjmë ortakë edhe fëmijët në mënyrë që t'u injektojmë ndërgjegjësimin e përgjegjësisë sociale.

Nëse periudhën tremujore të pushimeve verore e vlerësojmë ashtu si duhet, mundësojmë çlodhjen e fëmijëve nga lodhja e shkollës dhe mbështesim zhvillimin e tyre të shumëanshëm social, mendor, shpirtëror e fizik.

Ju urojmë fëmijëve dhe prindërve pushime sa më produktive, të shëndetshme dhe të gëzuara...





FUQIA E TRURIT

SEKRETI QËNDRON TEK VITAMINAT

Shëndeti i mendjes bazohet ndjeshëm në një regjim të pasur ushqimor me produkte që stimulojnë çdo qelizë të tij. Më poshtë do të gjeni një listë të 7 vitaminave më të mira që fuqizojnë trurin, përmirësojnë kujtesën dhe performancën mendore.

7 VITAMINA TË MIRA PËR TRURIN

VITAMINA A

Të gjithë i njohim vlerat e vitaminës A për shëndetin.

Por kjo vitaminë është thelbësore për zhvillimin e shëndetshëm të trurit.

Vitamina A zgjeron aftësitë e mendjes dhe të sistemit nervor.



Ajo përmirëson ndërlidhjen mes zonës së kujtesës dhe mësimi dhe zonës së qelizave.

Kjo vitaminë shërben si antioksidant, një mjet i fuqishëm kundër radikaleve të lira.

Burimet më të mira të vitaminës A janë spinaqi, pjeshka, mëlçia dhe kajsitë.

ACIDI FOLIK

Është një nga format e vitaminës B9 dhe mban nën kontroll qelizat e trurit.

Acidi folik forcon kujtesën afat shkurtër dhe vigjilencën dhe largon amullinë në veprime dhe letargjinë.



Disa prej burimeve ushqimore më të pasura me acid folik janë barishtet, thjerrëzat, fasulet dhe bishtajoret.

VITAMINA B6

Është një nga vitaminat e kompleksit B e dobishme për një kujtesë të fortë.

Disa nga burimet më të mira të kësaj vitamine janë pjeperi, mishi, drithërat e pasuruar dhe fasulet.

VITAMINA B12

Kjo vitaminë është jetësore për shëndetin e qelizave nervore. Ajo mban të paprekur mielinën e cila mbulon fibrat nervorë dhe lëshon impulse elektrike në tru.

Në këtë mënyrë, kjo vitaminë parandalon sëmundjet e trurit.

Vitamina B12 parandalon depresionin dhe luhatjet e humorit dhe rrit vigjilencën.

Ajo parandalon humbjen e kujtesës.



Disa nga burimet më të mira të kësaj vitaminë janë peshku, mishi i shpendëve dhe viçit.

Ju mund të përdorni edhe suplemente të vitaminës B12 në farmaci.

Të dhënat tregojnë se spirulina është shumë e pasur me vitaminë B12.

VITAMINA C

Radikalet e lira janë një rrezik madhor i qelizave të trurit.

Mënyra më e mirë për të parandaluar dëmin e këtyre radikaleve është marrja e antioksidantëve.

Vitamina C e luan këtë rol shkëlqyeshëm dhe siguron shëndetin jo vetëm të trurit por edhe të sistemit imunitar dhe zemrës.

Burime të mira të vitaminës C janë agrumet dhe bishtajoret.



VITAMINA D

Ndihmon shëndetin e qelizave të trurit dhe mirëmbajtjen e tyre.

Burime të mira të vitaminës D janë shpendët, mishi i viçit, mëlçia, djathi, peshku, etj.

Vegjetarianët mund të konsumojnë kërpudha që përmbajnë vitaminën D2, një formë e vitaminës D.

Drita e diellit është gjithashtu një burim i mirë i kësaj vitamine.

VITAMINA E

Kjo vitaminë mbron qelizat e trurit dhe nervave nga dëmet e shkaktuara prej radikaleve të lira.

Ajo ndalon ose vonon progresin e sëmundjes së Alzheimerit tek të moshuarit.

Patatja e ëmbël, barishtet, drithërat dhe arrorët janë burime shumë të mira të kësaj vitamine.





Ju ofron:

Kushte bashkëkohore,
ushqim cilësor dhe të kontrolluar,
staf të kualifikuar.

Ju mirëpresim!




Lagja Perash, Bulevardi Mehmet Pashë Plaku,
Pranë Xhamisë Perash, Shkodër

+355 67 47 39389

- 1 Staf arsimor cilësor
- 2 Kushte arsimore sipas standarteve të larta
- 3 Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive
- 4 Klasa dhe laboratorë të kompletuar
- 5 Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim



CIKLI FILLOR
(djem dhe vajza)
1
NGA KLASA E **1**-RË
DERI NË KLASËN E **5**-TË



“Urdhëroji njerëzit e tu
të falin namazin
dhe ji i vazhdueshëm
edhe vetë në të.
Ne nuk kërkojmë
furnizim prej teje,
Ne jemi ata
që të furnizojmë ty.”

(TaHa, 132)